Kumbona e së Diellës

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.7/8, Korrik - Gusht 2015

Shën Antoni (Ndou) i Padovës
“Mrekullibërësi”
(1195-1231)

Më 13 qershor Kisha e përkujton Shën Antonin (Ndou), meshtar dhe mësues i Kishës. Shën Antoni i Padovës fillimisht quhej Fernando Bulhão dhe Antoni i Lisbonës. Ndër katoliket shqiptarë njihet si: "Shna Ndoi ose Shna Ndou" (Nua, Nush, Nosh,Nok, Toni, Anton, Tonini, të femrat Tone, Tole etj.) , e ndër të krishterët ortodoksë "Shën Andoni". Antoni u lind me 15 gusht 1195 në Lisbonë në një familje të njohur dhe të pasur portugeze. I ati quhej Martin Afonso dhe ishte kalores i mbretit dhe sipas disa shënimeve ishte pasardhës i Gofredi i Buliones, kurse e ëma quhej Marie Terezia Taveira.

Mendohet , se i ati, ka dëshiruar qe Antoni të jetë me profesion ushtarak. Ndërsa, Antoni, kundër vullnetit të t 'atit, në vitin 1210 në moshën 15 vjeçare, vendos të hyje dhe të bëhet pjesë e Urdhrit Agostinian të Abacisë se Shën Vinçencit, duke braktisur të mirat dhe pushtetin e shtëpisë atërore.

Ne fillim i përkiste urdhrit agostinian në Koimbra (1210), e me pas në vitin 1220 urdhrit françeskan. Ai udhëtoi shumë, duke jetuar me parë në Portugali dhe pastaj në Itali. Në vitin 1221, në Porciuncola, takoi Shën Françeskun e Asizit, i cili e ftoi në kuvendin e Montepaolos, pranë Forlit, ku filloi veprimtarinë e tij si predikues.

Pastaj shpërngulet në Bolonija e me pas në Padova dhe është shenjti mbrojtës i këtij qyteti. Vdiq me 13 qershor1231 në Arqela të Padovës.

Shën Antoni vdiq në moshën 36 vjeçare pas një jete shenjtore. Për numrin e shumte të mrekullive qe i njihen atij u kanonizua një vit pas vdekjes, nga Papa Gregori IX. Në vitin 1946, Papa Pio XII e ka renditur Shën Antonin mes mësueseve të Kishës katolike, dhe i ka dhëne titullin doktor i ungjillëzimit.

Bazilika e madhe e Padovës është kushtuar Shën Antonit. Festa e tij është me 13 qershor dhe në Padova festohet me solemnitete të jashtëzakonshëm.

Në hapësirën shqiptare është një nga shenjtët më të dashur e më të njohur nga të krishterët. Ka shumë kisha dhe famulli, si në Shqipëri ashtu në Kosovë (Gjakova, Prishtina. Gllogjani dhe Bînça), e në veçanti është e njohur Shenjtërorja e Laçit të Sebastit në Shqipëri e cila frekuentohet edhe nga besimtaret ortodoks dhe mysliman. Në Mal të Zi, kemi famullin e Tuzit të Gucisë , kushtuar këtij shenjti. Pastaj populli e kremton edhe në Braticë, poashtu me miq e lusin edhe fisi i Kojes Kuçit.

Radio Vatikani
ENCIKLIKA E PAPA FRANÇEKUT 4

Georg Frendo
FIGURA E MESHTARIT NË DOKTRINË 10

Don Nosh Gjolaj
MIRËNJOHJA E TË DREJTËS 12

Dr. Don Lush Gjergji
OSCAR ROMERO 14

Don Nosh Gjolaj
NGRITJA E ZOJËS SË BEKUAR 17

Dr. Tonin Çobani
PESË MUNDIMET E FISHTËS 19

Iliriana Koleka
KONGRESI I MANASTIRIT 22

Eugjen Merlika
FAMILJA SHQIPTARE NË SHEKUJ 26

Dom Nikë Ukgjini
NjË GJYSMË SHEKULLI JETË MESHTARIE 30

Redaksia
OBORRI I KATEDRALES SË SHKODRËS 31

VITRINA E LIBRIT 32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 7/8 (478-479) Korrik - Gusht 2015

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
***Imzot* Angelo MASSAFRA**

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Enciklika e Papa Françeku "LËVDUAR QOFSH"

PLANETI KA NEVOJË PËR NJË "EKOLOGJI TË VËRTETË"

Papa, nuk e besoj se shqetësimet tona ekologjike do të mund të sjellin ndonjë rezultat të rëndësishëm". Enciklika e merr emrin nga lutja "Lëvduar qofsh, o Zoti im" e Shën Françeskut që, në Këngën e Krijesave, na kujton se toka, shtëpia jonë e përbashkët, "është edhe si motër, me të cilën jetojmë ditë për ditë, e edhe si nënë e bukur, që na shtrëngon ndër krahë".

"Çfarë tip të botës dëshirojmë t'u lëmë atyre, që do të vijnë pas nesh, fëmijëve në rritje?" (160). Kjo, eshte pyetja në qendër të Lëvduar qofsh, Enciklikës (letër qarkore) së shumëpritur, që Papa Françesku ia kushton shtëpisë së përbashkët. "Pyetja nuk ka të bëjë thjesht me ambientin, parë në mënyrë të izoluar, sepse problemi nuk mund të ngrihet vetëm pjesërisht". E kjo të shtyn të bësh pyetje edhe për kuptimin e vetë qenies dhe të vlerave bazë të jetës shoqërore: "Për çfarë qëllimi erdhëm në jetë? Pse punojmë e luftojmë? Pse kjo tokë ka nevojë për ne?". Nëse nuk do t'ia bëjmë vetes këto pyetje themelore, shkruan Papa, nuk e besoj se shqetësimet tona ekologjike do të mund të sjellin ndonjë rezultat të rëndësishëm".

Enciklika e merr emrin nga lutja "Lëvduar qofsh, o Zoti im" e Shën Françeskut që, në Këngën e Krijesave, na kujton se toka, shtëpia jonë e përbashkët, "është edhe si motër, me të cilën jetojmë ditë për ditë, e edhe si nënë e bukur, që na shtrëngon ndër krahë". (1). Ndërsa ne vetë "jemi toka (cfr Zan 2,7). Vetë trupi ynë gatuhet nga elementet e planetit; ajri i tij na jep frymën e uji na mban gjallë e na freskon" (2).

Tani, kjo tokë, e keqtrajtuar dhe e plaçkitur vajton, e dënesët e saj bashkohen me ato të të gjithë njerëzve të braktisur udhëve të botës. Papa Françesku na fton t'i dëgjojmë, duke i nxitur të gjithë e secilin – individë, familje, fise, kombe e bashkësi ndërkombëtare – për të bërë "kthesë ekologjike", sipas shprehjes së Shën Gjon Palit II. Fton, pra, për të ndërruar rrugë, duke marrë mbi vete detyrën dhe angazhimin e fisëm të "kujdesit për shtëpinë e përbashkët".

Njëkohësisht Papa Françesku pranon se "Vërehet një ndjeshmëri në rritje lidhur me ambientin dhe kujdesin ndaj natyrës e thellohet gjithnjë më shumë shqetësimi i dhimbshëm, për atë që po i ndodh planetit tonë" (19), duke e përligjur shikimin plot shpresë, që ndjehet fort në të gjithë Enciklikën, për t'u drejtuar, më pas, të gjithëve, një mesazh të qartë e plot besim: "Njerëzimi nuk e ka humbur ende aftësinë e bashkëpunimit për ndërtimin e shtëpisë sonë të përbashkët" (13). "Qenia njerëzore është ende e zonja të vërë dorë pozitivisht" (58), "nuk ka humbur gjithçka, sepse njerëzit, të aftë për të rënë poshtë e më poshtë, munden edhe të ngrihen lart e më lart, të bëjnë kthesë drejt rrugës të së mirës e të rilindur për një jetë të re" (205).

Natyrisht Papa u drejtohet besimtarëve katolikë, duke rimarrë (cituar bërë të vetat) fjalët e Gjon Palit II: "Të krishterët, në veçanti, vërejnë se detyrat ndaj gjithësisë, detyrat ndaj natyrës e Krijuesit, janë pjesë e pandarë e fesë së tyre" (64), duke u propozuar "në mënyrë të posaçme të hyjnë në dialog me të gjithë për problemet e shtëpisë sonë të përbashkët"(3): dialogu përshkon gjithë tekstin e, në kapitullin e 5-të, bëhet mjet për t'i përballuar e për t'i zgjidhur problemet. Që në fillim Papa Françesku kujton se "edhe Kishat e bashkësitë e tjera të krishtera, ashtu si dhe fetë e tjera, e kanë vënë theksin mbi këtë shqetësim të thellë e edhe kanë reflektuar" mbi temën e ekologjisë (7). Madje e mbështet shprehimisht kontributin e tyre, duke nisur nga ai "i Patrikut të dashur Ekumenik Bartolomeu" (7) cituar gjerësisht në numrat 8-9. Disa herë të tjera, pastaj, Papa i falënderon protagonistët e këtij angazhimi - si njerëzit e veçantë, ashtu edhe shoqatat ose institucionet. Duke pranuar se "reflektimi i një morie shkencëtarësh, filozofësh, teologësh e organizatash shoqërore, e pasuron mendimin e Kishës për këto çështje" (7), Papa i fton të gjithë ta pranojnë "ndihmesën që mund të japin fetë për ekologjinë e dhe për zhvillimin e gjithanshëm të gjinisë njerëzore" (62).

Përmbajtja e Enciklikës skicohet në n. 15, për t'u shtjelluar, më pas, në gjashtë kapituj. Niset nga paraqitja e situatës, duke filluar nga arritjet më të mira shkencore që kemi sot (kap.1), për të kaluar tek ballafaqimi me Biblën dhe me traditën judaiko-kristiane (kap.2), duke vënë në dukje se rrënjët e problemeve (kap. 3), duhen kërkuar tek teknokracia dhe vetëbesimi i tepruar i qenies njerëzore. Enciklika propozon (kap. 4) "ekologjinë e gjithanshme", që përfshin qartë përmasat njerëzore e shoqërore"(137), të lidhura pazgjidhshmërisht me çështjen ambientale. Në këtë perspektivë, Papa Françesku propozon (kap. 5) të fillojë në çdo nivel të jetës shoqërore, ekonomike e politike, një dialog i ndershëm, që të krijojë e të realizojë procese transparente e, më pas, kujton (kap. 6) se asnjë projekt nuk mund të jetë i frytshëm, nëse nuk frymëzohet nga një ndërgjegje e formuar dhe e përgjegjshme. Jep edhe këshilla për t'u rritur në këtë drejtim në nivelin edukativ, shpirtëror, kishtar, politik e teologjik. Teksti përfundon me dy lutje, njëra kushtuar ndarjes së përbashkët të pasurive të universit me të gjithë ata që besojnë "në një Zot të vetëm krijues e atë" (246) e tjetra, për ata që praktikojnë besimin në Jezu Krishtin, ritmuar me refrenin "Lëvduar qofsh!", me të cilën Enciklika hapet e mbyllet.

Teksti përshkohet nga disa boshte tematike, të shtjelluara me një larmi perspektivash të ndryshme, që çojnë në një përfundim të vetëm: "lidhja e ngushtë ndërmjet të varfërve dhe brishtësisë së planetit; bindja se çdo gjë në botë është e lidhur pazgjidhshmërisht me tjetrën; kritika kundër paradigmës se re dhe formave të pushtetit, që rrjedhin nga teknologjia; ftesa për të kërkuar mënyra të tjera të kuptimit të ekonomisë e të progresit; vlera që ka në vetvete çdo krijesë; kuptimi njerëzor i ekologjisë; nevoja për diskutime të sinqerta e të ndershme; përgjegjësia e rëndë e politikës ndërkombëtare e lokale; kultura e hedhurinës dhe propozimi për një stil të ri të jetës" (16).

Kapitulli I
– Çfarë po ndodh në shtëpinë tone

Në këtë kapitull përmblidhen arritjet shkencore më të freskëta në fushën ambientale, si mënyrë për ta dëgjuar britmën e gjithësisë, "për ta shndërruar në vuajtje vetjake, vuajtjen e botës e për të përcaktuar kontributin që mund të japë secili"(19). Shoshiten, kështu, "aspektet e ndryshme të krizës së sotme ekologjike" (15).

Ndryshimet klimaterike: "Ndryshimet klimaterike janë problem global me pasoja të rënda ambientale, shoqërore, ekonomike, distributive e politike dhe përbëjnë një nga sfidat kryesore aktuale për njerëzimin"(25). Nëse "klima është pasuri e përbashkët, e të gjithëve e për të gjithë" (23), barra më e rëndë e ndryshimeve të saj bie mbi kurrizin e të varfërve, por shumë nga ata, "që kanë më tepër pasuri e pushtet ekonomik ose politik, duket se përqendrohen posaçërisht në maskimin e problemeve a në fshehjen e simptomave"(26): "mungesa e reagimeve përballë këtyre dramave të vëllezërve tanë, është shenjë e humbjes së asaj ndjenje të përgjegjësisë për njerëzit e tjerë, mbi të cilën bazohet çdo shoqëri civile"(25).

Çështja e ujit: Papa pohon fare qartë se "shfrytëzimi i ujit të pijshëm e të sigurt është e drejtë njerëzore thelbësore, themelore e universale, sepse prej saj varet mbijetesa e njerëzve e, prej këndej, edhe kusht për ushtrimin e të drejtave të tjera njerëzore". T'i lësh të varfrit pa ujë, do të thotë t'ua mohosh të drejtën "për jetë, që lidhet ngushtë me dinjitetin e tyre të paprekshëm"(30).

Mbrojtja e biodiversitetit: "Çdo vit zhduken mijëra lloje bimësh e kafshësh, që nuk do të mund t'i njohim kurrë më e fëmijët tanë nuk do të mund t'i shohin, sepse të humbura përgjithmonë"(33). Nuk janë thjesht burime të rastit, që mund të shfrytëzohen ose jo, por kanë vlerë në vetvete. "Në këtë perspektivë janë të lavdërueshme, e nganjëherë edhe të admirueshme, përpjekjet e shkencëtarëve dhe të teknikëve, që përpiqen t'i zgjidhin problemet e krijuara nga vetë njeriu", por ndërhyrja njerëzore, kur vihet në shërbim të financës e të konsumizmit "e bën

tokën, në të cilën jetojmë, më pak të pasur, më pak të bukur, gjithnjë më të kufizuar e më ngjyrë hiri".(34).

Borxhi ekologjik: në kuadrin e etikës së marrëdhënieve ndërkombëtare, Enciklika flet për ekzistencën e një "borxhi të vërtetë ekologjik"(51), që i ka posaçërisht Veriu, Jugut të botës. Të gjithë kanë përgjegjësitë e veta për ndryshimet klimaterike, por përgjegjësia më e rëndë bie mbi vendet e zhvilluara.

I vetëdijshëm për mosmarrëveshjet lidhur me këto problematika, Papa Françesku preket thellë përballë "reagimeve të pafuqishme" e dramave që jetojnë një mori njerëzish. Megjithëse shembujt pozitivë nuk mungojnë (58), vërehet "një farë ngathtësie e, jo më pak, edhe një mungesë e çkujdesur përgjegjësie" (59). Mungon kultura e nevojshme (53) si dhe gatishmëria për të ndryshuar stilin e jetës, të prodhimit e të konsumit(59), ndërsa "duhet krijuar me urgjencë sistemi ligjor që […] siguron mbrojtjen e ekosistemeve"(53).

Kapitulli II
– Ungjilli i krijimit

Për të përballuar problematikat e shpjeguara në kapitullin e mëparshëm, Papa Françesku rilexon rrëfimet e Biblës, jep një vizion të gjithmbarshëm, që buron nga tradita hebraiko-kristiane dhe nënvizon "përgjegjësinë e tmerrshme" (90) të qenies njerëzore ndaj gjithësisë, lidhjen e ngushtë ndërmjet gjithë krijesave dhe faktin se "ambienti është pasuri kolektive, trashëgimi e mbarë njerëzimit, për të cilën kanë përgjegjësi të gjithë"(95).

Në Bibël "Zoti, që çliron e shpëton, është po Ai, që krijoi gjithësinë […] në Të shkrihen në një dashuria e forca"(73). Me rëndësi të dorës së parë, rrëfimi kushtuar krijimit, për të reflektuar mbi marrëdhëniet ndërmjet qenies njerëzore edhe krijesave të tjera e edhe për të treguar sesi mëkati e prish ekuilibrin e mbarë gjithësisë, në tërësinë e saj: "Këto rrëfime na kujtojnë se jeta njerëzore bazohet mbi tri marrëdhënie themelore, lidhur ngushtë njëra me tjetrën: marrëdhënia me Zotin, me të afërmin e ajo me tokën. Sipas Biblës, këto tri lidhje jetike u këputën, e jo vetëm jashtë nesh, por edhe në shpirtin tonë. E kjo këputje është mëkat"(66). Prej këndej, edhe pse "nganjëherë të krishterët i shpjeguan Shkrimet Shenjte në mënyrë jo korrekte, sot duhet ta hedhim poshtë me forcë se nga fakti i krijimit tonë sipas shëmbëlltyrës së Zotit, e nga mandati që na dha për ta nënshtruar tokën, mund të arrihet në përfundimin e sundimit absolut mbi të gjitha krijesat e tjera(67). Qenies njerëzore i takon përgjegjësia për ta 'kultivuar e për ta ruajtur' kopshtin e botës (cfr Zan 2,15)" (67), duke e ditur se "qëllimi përfundimtar i krijesave të tjera nuk jemi ne. Përkundrazi, të gjitha ecin së bashku me ne e përmes nesh, drejt cakut të përbashkët, që është Zoti"(83).

Fakti që njeriu nuk është padron i universit, "nuk do të thotë se duhet vënë shenja e barazimit ndërmjet të gjitha qenieve të gjalla e se u duhet mohuar vlera e tyre e veçantë, që i dallon; e aq më pak do të thotë se duhet hyjnizuar toka, gjë që do të na linte pa thirrjen për të bashkëpunuar me të e për ta mbrojtur në ligështinë e saj"(90). Në këtë perspektivë, "çdo keqtrajtim i secilës nga krijesat 'është në kundërshtim me dinjitetin njerëzor'"(92), por "Nuk mund të jetë e vërtetë ndjesia e bashkimit të ngushtë me qeniet e tjera të natyrës, nëse ndërkohë ndër zemra nuk ka dhembshuri, mëshirë, shqetësim për njeriun"(91). Është e domosdoshme vetëdija e bashkimit universal: "të krijuar nga i njëjti Atë, ne, të gjitha qeniet e universit, lidhemi me hallka të padukshme, për të formuar kështu një lloj familjeje universale[…], që na shtyn ta respektojmë gjithçka, me një respekt të shenjtë, të përzemërt, të përvuajtur" (89).

Në përfundim të kapitullit, thelbi i zbulesës së krishterë: "Jezusi tokësor", me "lidhjen e Tij tejet konkrete e plot me dashuri për botën", është "i gjallë e i lavdishëm, i pranishëm në mbarë rruzullin me sundimin e tij universal"(100).

Kapitulli III
- Rrënjët njerëzore të krizës ekologjike

Në këtë kapitull analizohet gjendja aktuale, "në mënyrë që të kuptohen jo vetëm simptomat, por edhe shkaqet më të thella"(15), në dialog me filozofinë dhe me shkencat njerëzore.

Reflektimet e para të kapitullit janë ato mbi teknologjinë: pranohet me mirënjohje kontributi në përmirësimin e kushteve të jetesës (102-103). Por ajo u jep "atyre që kanë në dorë dijen, e posaçërisht pushtetin ekonomik, mundësinë për të ushtruar një sundim tronditës mbi gjininë njerëzore në tërësi e edhe mbi mbarë rruzullimin"(104). Janë pikërisht logjikat e sundimit teknokratik ato, që çojnë në shkatërrimin e natyrës dhe në shfrytëzimin e njerëzve e të popullsive më të ligshta. "Paradigma teknokratike priret ta ushtrojë sundimin edhe mbi ekonominë e mbi politikën"(109), duke e penguar të pranojë se "tregu, i vetëm, nuk mund ta sigurojë zhvillimin njerëzor të gjithanshëm dhe gjithë përfshirjen shoqërore".

Në rrënjë të epokës moderne diagnostikohet teprimi i antropocentrizmit (116): njeriu nuk arrin më ta kuptojë cili është vendi i tij, në lidhje me botën, prej këndej, mban qëndrim vetëvlerësues, të përqendruar kryesisht mbi vetveten e mbi pushtetin e vet. Prej këndej pason logjika "përdor e flak", që përligj çdo lloj hedhurine ambientale a njerëzore qoftë e që e trajton tjetrin e natyrën thjesht si objekt, duke krijuar, kështu, mijëra forma të sundimit. Jemi para logjikës, që çon në shfrytëzimin fëmijëve, në braktisjen e pleqve, në kthimin e të tjerëve në skllevër, në mbivlerësimin e aftësisë së tregut për t'u vetërregulluar, në praktikimin e trafikut të njerëzve, në tregtinë e lëkurave të kafshëve në zhdukje e sipër e të diamanteve, nga të cilat pikojnë pika gjaku. Është e njëjta logjikë e mafieve të shumta, e trafikantëve të organeve, të drogës e të asgjësimit të fëmijëve të palindur, sepse nuk përkojnë me planet e prindërve (123).

Në këtë dritë, Enciklika përballon (trajton) dy probleme vendimtare për botën e sotme. Para së gjithash, atë të punës: "Në çdo bazë të ekologjisë së gjithmbarshme, që nuk e përjashton qenien njerëzore, është e domosdoshme të përfshihet vlera e punës"(124), ashtu si "Të heqësh dorë nga investimi mbi njeriun, për të arritur fitimin e menjëhershëm, është gjëja më e keqe për shoqërinë" (128).

I dyti ka të bëjë me përparimin shkencor, duke kujtuar qartë OGJM (Organizmat gjenetikisht të modifikuara) (123-136), "problem me karakter të ndërlikuar" (135). Ndonëse "në disa zona përdorimi i tyre i ka dhënë shtytje përpara zhvillimit ekonomik, duke ndikuar për zgjidhjen e disa problemeve, hasen vështirësi të ndjeshme, që nuk duhen bërë në asgjë"(134). Duke nisur nga "përqendrimi i tokave prodhuese në pak duar"(134). Papa Françesku mendon posaçërisht për prodhuesit e vegjël e bujqit në zonat fshatarake, për biolarmitë, për rrjetin e ekosistemeve. Prej këndej, është i nevojshëm "një diskutim shkencor e shoqëror i përgjithshëm e plot përgjegjësi, i aftë për ta shqyrtuar gjithë informacionin e mundshëm e për t'i thirrur sendet me emrin e vet", duke nisur "nga vijat e kërkimit të pavarur dhe ndërdisiplinor"(135).

Kapitulli IV
- Ekologjia e gjithanshme

Thelbi i propozimit të Enciklikës është ekologjia e gjithanshme, si paradigmë e re e drejtësisë; ekologji "e cila lidh vendin e veçantë të njeriut në këtë botë dhe marrëdhëniet me realitetin, që e rrethon" (15). Vërtet, nuk mund "ta konsiderojmë natyrën si diçka të ndarë prej nesh, ose si një kornizë të thjeshtë të jetës sonë" (139). Kjo vlen për jetën tonë në fusha të ndryshme: në ekonomi e në politikë, në kulturat e larmishme, në veçanti në ato më të kërcënuarat e, madje, edhe në çdo çast të jetës sonë të përditshme.

Perspektiva gjithëpërfshirëse vë në lojë edhe ekologjinë e institucioneve: "Nëse gjithçka është e ndërlidhur, edhe shëndeti i institucioneve në një shoqëri sjell pasoja për ambientin e për cilësinë e jetës njerëzore: 'Çdo lëndim i solidaritetit dhe i miqësisë shoqërore shkakton dëme ambientale'" (142).

Me shumë shembuj konkretë, Papa Françesku vijon të ritheksojë mendimin e tij: ndërmjet çështjeve ambientale dhe çështjeve shoqërore e njerëzore ekziston një lidhje, që nuk mund të këputet kurrë. Kështu, "analiza e problemeve ambientale është e

pandashme nga analiza e rrethanave njerëzore, familjare, urbane e të punës, si edhe nga marrëdhëniet e secilit me vetveten"(141), pasi "Nuk ka dy kriza të ndara, njëra ambientale e tjetra shoqërore, por një krizë shoqëroro-ambientale e vetme dhe e ndërlikuar"(139).

Kjo ekologji e gjithanshme "është e pandarë nga nocioni i së mirës së përbashkët"(156), e cila duhet kuptuar konkretisht: në kontekstin e sotëm, ku "vërejmë shumë pabarazi e ku janë gjithnjë e më të shumtë njerëzit, që mënjanohen, privohen nga të drejtat themelore", impenjimi për të mirën e përbashkët do të thotë të merren vendime solidare mbi bazën e një "opsioni preferencial për të varfrit" (158). E kjo është edhe mënyra më e mirë për të lënë një botë, që i ndjen detyrimet ndaj brezave të ardhshëm, jo me deklarata, por përmes impenjimit e kujdesit për të varfrit e sotëm, siç nënvizonte edhe Benedikti XVI: "përveç solidaritetit besnik ndërmjet brezave, duhet integruar nevoja urgjente morale për një solidaritet të përtërirë ndërmjet brezave"(162).

Ekologjia e gjithanshme është pjesë e jetës së përditshme, së cilës Enciklika i kushton vëmendje të veçantë, sidomos asaj në ambientin urban. Njeriu ka aftësi të mëdha përshtatjeje. "Janë për t'u admiruar krijimtaria e bujaria e njerëzve dhe e grupeve, të aftë t'i kapërcejnë kufizimet e ambientit, …duke mësuar ta orientojnë ekzistencën e tyre në mesin e çrregullimit e të pasigurisë"(148). Megjithatë, zhvillimi i vërtetë presupozon përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës njerëzore: hapësira publike, banesa, transporte, etj.(150-154).

Edhe "trupi ynë na vë në marrëdhënie të drejtpërdrejta me ambientin e me qenie të tjera të gjalla. Pranimi i trupit si dhuratë e Zotit është i nevojshëm për të pranuar krejt botën si dhuratë të Atit Qiellor e si shtëpi të përbashkët; përkundrazi, logjika e sundimit të trupit shndërrohet në logjikën, shpesh të stërholluar, të mbizotërimit të përgjithshëm"(155).

Kapitulli V
– Disa linja orientimi e veprimi

Ky kapitull i jep përgjigje pyetjes: çfarë mund e çfarë duhet të bëjmë? Analizat nuk mund të na mjaftojnë: duhen propozime "dialogu e veprimi, që të përfshijnë secilin prej nesh, por edhe politikën ndërkombëtare"(15) e "të na ndihmojnë të dalim nga spiralja e vetëshkatërrimit, në të cilën po thithemi"(163). Për Papën Françesku është e domosdoshme që ndërtimi i udhëve konkrete të mos bëhet në mënyrë ideologjike, sipërfaqësore, ose reduksioniste. Prandaj është i nevojshëm dialogu, term ky, i pranishëm në titullin e çdo seksioni të këtij kapitulli: "Ka diskutime për çështjet e ambientit, në të cilat është e vështirë të arrihet konsensusi. …Kisha nuk pretendon të vendosë për çështje shkencore, as ta zëvendësojë politikën, por [unë] ftoj për një debat të ndershëm e transparent, që nevojat e veçanta, ose ideologjitë të mos e dëmtojnë të mirën e përbashkët"(188).

Mbi këtë bazë, Papa Françesku nuk ka frikë të japë një gjykim të ashpër për dinamikat ndërkombëtare të kohëve të sotme: "Mbledhjet botërore për ambientin, të viteve të fundit, nuk u janë përgjigjur aspiratave, sepse, për mungesë vendimi politik, nuk kanë arritur marrëveshje globale për ambientin, vërtet domethënëse dhe efikase"(166). E pyet "Pse dëshirojnë ta ruajnë sot, një pushtet që do të kujtohet për paaftësinë e ndërhyrjes, kur kjo ishte urgjente dhe e nevojshme?"(57). Siç kanë përsëritur shpesh Papët, duke u nisur nga Enciklika "Pacem in terris", duhen forma e mjete të frytshme të qeverisjes globale(175): "kemi nevojë për një marrëveshje mbi regjimet e qeverisjes për krejt gamën e të ashtuquajturave pasuri të përbashkëta globale"(174), meqë "mbrojtja ambientale nuk mund të sigurohet vetëm mbi bazën e llogaritjeve financiare të kostos

dhe të përfitimit. Ambienti është një nga pasuritë, që mekanizmat e tregut nuk janë në gjendje ta mbrojnë, ose ta promovojnë si duhet" (190, që citon fjalët e "Doracakut të doktrinës shoqërore të Kishës").

Gjithnjë në këtë kapitull, Papa Françesku ngul këmbë në zhvillimin e proceseve vendimmarrëse të ndershme e transparente, për "të shoshitur" cilat prej politikave dhe nismave afariste mund të çojnë "në një zhvillim të vërtetë të gjithanshëm" (185). Në veçanti, studimi i ndikimit mbi ambientin për një projekt të ri "kërkon procese politike transparente, që i nënshtrohen dialogut, ndërsa korrupsioni, që e fsheh ndikimin e vërtetë ambiental të një projekti në këmbim të favoreve, shpesh, sjell marrëveshje të dyshimta, që i shmangen detyrës për informim dhe debatit të thelluar" (182).

Veçanërisht e fuqishme është thirrja drejtuar atyre që kanë detyra politike, që të largohet nga "logjika efiçentiste dhe 'imediatiste'", nga logjika me prodhimtari të menjëhershëm (181), mbizotëruese sot: "nëse do të ketë guxim ta bëjë këtë, mund ta kuptojë sërish dinjitetin, që Zoti i ka dhënë si njeri e, pas kalimit të tij në këtë histori, do të lerë dëshminë e përgjegjësisë së fisme" (181).

Kapitulli VI
– Edukimi dhe përshpirtëria ekologjike

Kapitulli i fundit shkon drejt e në zemër të kthesës ekologjike, për të cilën fton Enciklika. Rrënjët e krizës kulturore veprojnë në thellësi e nuk është e lehtë të ripërcaktohen sjellje e zakone. Edukimi dhe formimi mbeten sfida qendrore: "çdo ndryshim ka nevojë për motivacion e për një udhë edukative"(15); përfshihen të gjitha fushat e edukimit, së pari "shkolla, familja, mjetet e komunikimit, katekizmi" (213).

Fillimisht, duhet "të synojmë një stil tjetër jetese" (203-208), që krijon edhe mundësinë "për të ushtruar presion të shëndoshë mbi ata, që kanë në dorë pushtetin politik, ekonomik e shoqëror" (206). Kjo ndodh kur vendimet e konsumatorëve arrijnë "ta ndryshojnë sjelljen e ndërmarrjeve, duke i detyruar ta mendojnë përsëri ndikimin mbi ambientin dhe modelin e prodhimit" (206).

Nuk mund të nënvlerësohet rëndësia e rrugëve të edukimit ambiental, të afta të ndikojnë mbi gjestet e sjelljet e përditshme, që nga ulja e konsumit të ujit, tek grumbullimi i diferencuar i mbeturinave e deri tek "fikja e dritave që s'përdoren" (211): "Një ekologji e gjithanshme përbëhet edhe nga gjeste të thjeshta të përditshme, me të cilat e thyejmë logjikën e dhunës, të shfrytëzimit, të egoizmit"(230). E gjithë kjo do të jetë më e thjeshtë, duke u nisur nga një këndvështrim kundrues, që vjen nga feja: "Për besimtarin, bota nuk kundrohet nga jashtë, por nga brenda, duke njohur lidhjet me të cilat Ati Qiellor na ka bashkuar me të gjitha qeniet e tjera. Përveç kësaj, duke përmirësuar aftësitë e veçanta, që Zoti i ka dhënë çdo besimtari, kthesa ekologjike e shtyn atë të zhvillojë krijimtarinë dhe entuziazmin" (220).

Kthehet linja e propozuar në "Evangelii Gaudium": "Thjeshtësia, e jetuar me liri e vetëdije, është çliruese" (223), po ashtu si "Lumturia kërkon vetëdijen e kufizimit të disa nevojave, që na trullosin, duke mbetur kështu në dispozicion të mundësive të shumta, që na jep jeta"(223); në këtë mënyrë është e mundur "ta ndjejmë sërish se kemi nevojë për njëri-tjetrin, se kemi përgjegjësi ndaj të tjerëve e ndaj botës, se ia vlen të jemi të mirë e të ndershëm"(229).

Shenjtorët na shoqërojnë në këtë udhë. Shën Françesku, i cituar mëse një herë, është "shembull i shkëlqyer i kujdesit për çka është e brishtë, shembull i ekologjisë së gjithanshme, jetuar me gëzim"(10), model, që na tregon si "janë të pandashme shqetësimi për natyrën, drejtësia ndaj të varfërve, impenjimi në shoqëri e paqja e brendshme"(10). Por enciklika kujton edhe shën Benediktin, shën Terezën e Lisieux dhe të Lumin Charles de Foucauld.

Pas "Laudato si", rrëmimi i ndërgjegjes, mjeti që Kisha e këshillon gjithmonë për të orientuar jetën në dritën e marrëdhënieve me Zotin, duhet të përfshijë një përmasë të re, duke pasur parasysh jo vetëm si përjetohet bashkimi me Zotin, me të tjerët e me vetveten, por edhe me të gjitha krijesat e me natyrën.

Georg Frendo
Ipeshkëv

FIGURA E MESHTARIT NË DOKTRINËN E PAPË FRANÇESKUT

(Fund)

"Mos të harrojmë se pushteti autentik është shërbim, edhe Papa, duke ushtruar pushtetin e tij, duhet të zbatojë atë shërbim që arrin kulmin e tij të shkëlqyeshëm mbi kryqin".

5. SHPIRT THELLËSISHT I MËSHIRSHËM:

Duhet të pranojmë se pak a shumë të gjithë jemi trashëgimtarë i një mendësie tepër legaliste dhe kazuistike, e asajj mendësie ku dashuria për ligjin mori përparësinë mbi ligjin e dashurisë. Është shumë e qartë se Papa Françesku, që nga fillimi i pontifikatit të tij, ka luftuar dhe po lufton shumë kundër këtij mentaliteti. Vetë moto që zgjodhi për veten si Papë, "Miserando atque eligendo", tregon një eksperiencë personale kur, 17 vjeçar, e ndjeu thirrjen e tij për jetën meshtarake. Ishte pikërisht më 21 shtator, festa e Shën Mateut, ai mëkatar ndaj të cilit Jezusi tregoi mëshirë dhe të cilin zgjodhi si apostull.

Në të parin fjalim para lutjes Angelus tha: "Hyji nuk lodhet kurrë së faluri". Dhe në Evangelii gaudium (n. 44) ai na kujton ne, meshtarët, se "rrëfyestorja nuk është një dhomë torturash, por një përballje me mëshirën e Zotit".

Në katedralen e Napolit tha se kemi harruar punët e mëshirës. Dhe këtu më lejoni të citoj disa pjesë nga fjalimi i tij u drejtuar meshtarëve dhe rregulltarëve në atë Katedrale:

"Duhet të rimarrim punët e mëshirës, si ato të trupit edhe ato të shpirtit. Në qoftë se kam pranë shtëpisë sime një person që është i sëmurë dhe dëshiroj të shkoj ta vizitoj, por koha që kam në dizposicion përkon më momentin e telenovelës, e në mes telenovelës dhe bërjes së një pune të mëshirshme zgjedh telenovelen, kjo nuk shkon..."

Dhe nuk ka munguar të përmendë edhe thashetheme që dëmtojnë rëndë marrëdhëniet vëllazërore mes nesh: "Thashetheme janë shenjë që nuk ka vëllazëri, si në presbiter ashtu edhe në bashkësitë rregulltare. Dhe me lejoni të përdor këtë shprehje: terrorizmi i thashethemeve, sepse ai që merret me thashetheme është sikurse një terrorist që gjuan një bombë dhe shkatërron, ndërsa ai është jashtë... Në qoftë se unë kam diçka për t'ia thënë Ipeshkvit, të shkoj tek Ipeshkvi edhe mund t'i them: 'Ju jeni antipatik', dhe Ipeshkvi duhet të ketë kurajën të mos hakmerret. Kjo është vëllazëria!"

6. ANGAZHIM BARITOR: Sa shumë herë, në këto dy vjet, Françesku me këmbëngulje ka përsëritur se meshtarët duhet të jenë barinj, dhe jo administratorë! Duhet të dalin për t'u takuar me popullin, veçanërisht me delen e humbur. Meshtari që rri tek zyra nuk është një bari autentik.

Njëri mund të habitet duke lexuar sa herë Françesku ka përsëritur fjalë si: "Jini barinj me erën e deleve". Por si një person me shumë eksperiencë si epror i një bashkësie lokale, si provincial, dhe si ipeshkëv, e di mirë cilat janë tundimet kryesore në jetën e meshtarit sot, shumë hutime që mund të arrijnë që ai të braktisë lutjen dhe detyrën baritore.

Në meshën e Krizmës që kremtoi pak ditë pas zgjedhjes së tij tha: "Hiri bëhet aktiv dhe rritet varësisht nga sa ia dalim mbanë të japim vetveten dhe t'u japim ungjillin të tjerëve". Dhe shpreh keqardhjen e tij per ata meshtarë të mërzitur, të transformuar në koleksionistë duke braktisur detyrën e tyre që të jenë barinj në mes të grigjës dhe peshkatarë njerëzish (ibid).

Duke i kujtuar meshtarëve detyrën e tyre që të kujdesen për grigjën, i kujton gjithashtu se këtë mision nuk mund ta zbatojnë me fuqinë njerëzore apo me aftësitë e tyre, por me fuqinë e Shpirtit Shenjt, dhe sipas zemrës së Jezusit, që është zemër dashurie. "Në qoftë se nuk e bëni me dashuri, nuk shërben" (Audienca e përgjithshme, 26 mars 2014).

Papa tregon fisnikërinë dhe gëzimin e punës baritore me këto fjalë: "Bijtë shpirtërorë që Zoti ia jep çdo meshtari, ata që ai ka pagëzuar, familjet që u ka bekuar shtëpitë dhe i ka ndihmuar në ecje, të sëmurët që vuajnë, të rinjtë të cilët bën të rriten me katekizmin dhe formimin, të varfërit që ndihmon... këta janë

'Nusja' që ai është i lumtur ta trajtojë si të dashurën e vet e vetme" (Mesha e Krizmës, 17 prill 2014). Këtu Papa përdor fjalët "bijtë shpirtërorë"). Kështu na kujton një koncept që, sipas mendimit tim, sot nuk e theksojmë sa duhet: po flas për atësinë shpirtërore e meshtarit. Mbarështimi ynë meshtarak na jep këtë dinjitet: të bëhemi etër shpirtëror. Vetë Shën Pali u thotë Korintasve: "Unë ju linda në Jezu Krishtin" (1 kor 4, 15). Dhe Filemonit i shkruan: "Po të lutem për birin tim, të cilin e linda në pranga, për Onezimin" (rr. 10).

Kështu puna jonë baritore bëhet edhe burim gëzimi. Duke iu referuar tekstit të Isaisë, të cituar nga Jezusi në Sinagogën ("Shpirti i Hyjit më dërgoi..."), Papa komenton: "Punët e përmendura nga Jezusi nënkuptojnë aftësinë tonë të dhembshurisë, janë angazhime që prekin zemrën tonë. Gëzohemi me të fejuarit që martohen, qeshim me fëmijën që sjellin për pagëzim, shoqërojmë të rinjtë që përgatiten për martesën dhe krijimin e familjes, vajtojmë me atë që merr vajin e shenjtë në shtratin e spitalit, qajmë me ato që varrosin një person të dashur... Shumë emocione" (Mesha e Krizmës, 2 prill 2015).

Në meshën e Krizmës së këtij viti ka folur për lodhjet e ndryshme që përjetojnë meshtarët. Përmend "lodhjen e njerëzve, lodhjen e turmës"; e thotë se edhe vetë Jezusi ka përjetuar këtë lodhje, por është "një lodhje e bukur, lodhje përplot fryte dhe gëzime. Njerëzit që e ndiqnin, familjet që i dërgonin fëmijët e tyre që t'i bekonte, ata që ishin shëruar, që e afronin bashkë me miqtë e tyre, të rinjtë të entuziazmuar nga Mësuesi, nuk i linin madje as kohë për të ngrënë". Dhe vazhdon: "Kjo lodhje është e mirë, është një lodhje e shëndetshme. Është lodhja e meshtarit që ka erën e deleve, por me buzëqeshjen e babait që sodit bijtë dhe nipërit e tij. Asnjë krahasim me ata që kundërmojnë aroma të shtrenjta dhe që të shohin nga larg e nga lart".

7. DASHURI PËR KISHËN: Këtë tipar të meshtarit Papa e ka shprehur, në katedralen e Napolit, në këto pak fjalë: "Ti nuk mund ta duash Jezusin, në qoftë se nuk do e nusen". Dhe në audiencën e përgjithshme më 26 mars 2014 tha: "Një karakteristikë tjetër që nxit gjithmonë këtë bashkësi sakramentore me Jezusin është dashuria e përvëluar (appassionante) për Kishën... Në saje të Urdhrit të Shenjtë, mbarështuesi ia kushton vetveten tërësisht bashkësisë së tij dhe e dashuron me gjithë zemër: është pra familja e tij. Ipeshkvi, meshtarët e duan Kishën në bashkësitë e tyre, me dashuri të fortë".

Por Françesku e paraqet këtë dashuri për Kishën si rast për t'i shërbyer popullit me gëzim: "Nuk ka identitet – mandej gëzim të jetuari – pa anëtarësi aktive dhe të përkushtuar ndaj popullin besimtar të Zotit... Gëzimi meshtarak është një gëzim sikurse motra bindje. Bindja ndaj Kishës dhe Hierarkisë së saj... Por edhe bindje ndaj Kishës për të shërbyer: disponueshmëri e gatishmëri për t'i shërbyer të gjithëve" (Mesha e Krizmës, 17 prill 2014).

Në fjalimin që kishte përgatitur për takimin e tij me klerin dhe rregulltarët në Katedralen e Napolit (21 mars 2015) i ka referuar një farë individualizmi baritor, "i cili përfshin tundimin për të ecur përpara vetëm, ose me një grup të vogël të atyre që 'mendojnë si unë'. E dimë, megjithatë, se të gjithë janë të thirrur për të jetuar bashkimin në Krishtin në presbiter, rreth Ipeshkvit. Ju mund, por edhe duhet gjithmonë të kërkoni forma konkrete të përshtatshme për kohën dhe për realitetin e zonës, por ky hulumtim baritor dhe misionar duhet të bëhet në frymën e bashkimit, me përulësi dhe vëllazëri".

Para disa ditësh u habitëm kur morëm lajmin se Irlanda, në një referendum, ka votuar me një shumicë të madhe në favor të martesës gay. Si mund të shpjegohet se kjo Irlandë, Irlanda katolike, Irlanda e shenjtërve, i ka rënë mohit një të vërtete aq themelore dhe një parimi aq natyror si është martesa si thelbësisht heteroseksuale dhe ka ndjekur shembullin e shteteve më të shekullarizuar? Sipas mendimit tim, vota në këtë referendum ishte pjesërisht një votë proteste kundër një kishe që ka humbur besimin e shumicës së popullit. Mjafton të përmendim skandalin e ipeshkvit Casey e zbuluar në vitin 1992, skandalet e zbuluar në vitin 1993 e keqtrajtimit të fëmijëve në institutet dhe shkollat e shumë rregulltarëve dhe rregulltareve, dhe shumë skandale pedofilie nga ana e shumë meshtarëve.

Mos të harrojmë kurrë fjalët e Palit VI në Nxitjen Apostolike Evangelii Nuntiandi: "Njeriu bashkëkohor dëgjon me më shumë endje dëshmitarët sesa mësuesit, ose nëse i dëgjon, e bën për faktin sepse janë dëshmitarë". Le ta nxisim popullin tonë të lutet jo vetëm që të kemi më shumë thirrje për jetën meshtarake, por edhe që të kemi meshtarë më të shenjtë.

Don Nosh Gjolaj
Podgoricë

MIRËNJOHJA E TË DREJTËS - SHOKUT TË MARTESËS

(Fund)

Mendjelehtësia nuk ka aftësi për ta kuptuar tjetrin, ajo vetëm di ta dënojnë dhe ta kritikojnë tjetrin. Ajo për t'u zbuluar tjetrin është turp, është turp në qoftë se dikush di se ke dështuar, sepse është i mësuar vetëm në fitore. Zakonisht vetëm dëgjojmë pohimet e tilla: Çka kemi prej jetës? Çka presim prej saj? A ka ndonjë qëllim me pritur, që ajo të largohet?

8. Kryeneçësia dhe mendjelehtësia shprehia e vetmuarve

Zakonisht kryeneçësia nuk është asgjë tjetër përveç vetit e vetmuarit. Njeriu kryeneç është egoist dhe si i tillë gjysmak dhe nuk ka mundësi të ndaj si të mirë ashtu edhe barrën me tjetrin. Ai në një fare mënyrë është enigme e madhe njerëzore. Ai, as nuk pajtohet me pikëpamjet e partnerit, as nuk është solidar ndaj tjetrit, as në rastin e sëmundjes. Po ashtu edhe heshtja mund të ndërlidhet me kryeneçësi (mos interesim për tjetrin). Kryeneçësia është si ajo pasqyra e madhe, para të cilës qëndron partneri duke shikuar dhe krahasuar fuqitë e veta. Të gjitha gjestet dhe reaksionet i mbikëqyr dhe njëherë kënaqet me vete dhe dashurohet në narcizmin mashkullor. Kryeneçësia është helmi vdekjeprurës i dashurisë.

Heshtja nuk shpie askund përveç në vorbullën e vetmisë. Nganjëherë vetmia është më e rënd se varri. Mjafton vetëm një cikërrimë i telefonit për ta këputur heshtjen e rënd. Por megjithatë kryeneçësia e verbon dhe nuk e sill as numrin e telefonit, në qoftë edhe e sill, këtë e bënë prej instinktit me shpresë se do t'i lajmërohet në çdo moment dikush, nëpër mes të cilit e sheh veten. Nuk ka fuqi për ta tradhtuar kryeneçësinë e mishëruar, është e pamundur ta tradhtosh rojtarin e burgut.

Kryeneçësia (mendjelehtësia) njeriun e lërë gjysmak në gjysmën e rrugës. Qëndron përpara udhëkryqit jetës, por nuk ka guxim për t'u vendos. Egoizmi është i rrënjosur thellë, që e shoqëron si hidhërimin ashtu edhe jo sinqeritetin. Që nuk është asgjë tjetër përveç atij i duhet të llogaris në vetëbesimin egoist, që është i nevojshëm ta frenoi ndjenjat, që mos t'i zbulohet tjetrit, në pamjen reale. Edhe pse e parasheh humbjen totale, por narcizmi nuk lejon për ta përjetuar situatën e fituesit. Po ashtu ai nuk di të kërkoi falje, ai pret prej tjetrit që të kërkojë falje, ai tjetri është gjithherë fajtor.

Për me dash të falësh duhet të flitet me tjetrin, por më lehtë është të arsyetohet. Arsyetimi është gjithherë i gatshëm, zëri i partnerit në këtë rast është i huaj, pa emër dhe i panjohur. Jetën e përbashkët e bënë të pamundshëm, biseda me personin tjetër është si një far ironie për të cilin as nuk e njeh. Atëherë është e kuptueshëm sjelljet e skajshme, siç është heshtja, jo vetëm një ditës, javës, muajit ndoshta ma vite, përderisa skajshmi tjetër shamata që nuk ka të ndalur. Ndoshta duhet të besohet në

fatin me qenë fatalist, që të shkosh me kryeneçësinë tënde deri në fund, por vetëm një fjalë e zgjedhur, e bukur e cila ndërron drejtimin e ngjarjeve.

Mendjemadhësia (Kryeneçësia) është një prej ndjenjave kryesore, e cila e ka vlerën e lartë për ta çmuar veten. Në qoftë se përcaktohemi për të, por duhet edhe ta dimë, se nuk guxojmë të lidhemi nga ana e jashtme por nga ana e brendshme. Do t'i sillemi rreth vetes, siç sillet guri i mullirit, po ashtu duhet shpeshherë të kafshohet gjuha. Këto janë gërçet e mendjelehtësisë. Kush nuk është i aftë për t'i paguar, të tërhiqet më mirë nga fillimi.

Mendjelehtësia nuk ka aftësi për ta kuptuar tjetrin, ajo vetëm di ta dënojnë dhe ta kritikojnë tjetrin. Ajo për t'u zbuluar tjetrin është turp, është turp në qoftë se dikush di se ke dështuar, sepse është i mësuar vetëm në fitore. Zakonisht vetëm dëgjojmë pohimet e tilla: Çka kemi prej jetës?, çka presim prej saj? A ka ndonjë qëllim me pritur, që ajo të largohet?

Në pyetjet e tilla nuk ka përgjigje, sepse nuk di të vuajnë. Kohë pas kohet e ndiejnë veten, armiqësor kundrejt tjetrit, që bëhet plagë, e cila ka filluar të qelbësohet dhe është e domosdoshme të shërohet, por me të cilin ilaç (bar), edhe pse është vetëm në pamje. Ashtu është mësuar, që ta shfrytëzoi errësirën e natës për ta vëzhguar lëvizjet e tjetrit. Është mësuar, që mos të thërrasin, fshehtësi kuptohet, sepse thirrja nuk ndjek asnjë fjalë, si kishte dashur vëzhgoi pranin e shtëpisë, që mos ta qesin në pozitën për t'u skuqur. Edhe ka dëshiruar ta ndjekin, sepse e ka zbuluar dritën e syrit, që i jep forcë, edhe pse nuk është dritë, të behësh i brengosur.

Pyet, a e bënë këtë për çështje të xhelozisë, sepse e nxitë ndjenjat në veprim që vetëdijesohet. Ose është fakt i thjeshtë i teorive të zbraztë, me cilat nuk dëshiron të humb kontakt dhe as t'i këpus fijet e fundit, që e lidh me egoizmin e fshehur.

Por nuk është e çuditshme, te tipat e tillë, sa shpejt e humbin luftën, që përgatiten për një kohë të gjatë, dhe bëhen të pashërueshëm. Ja një gjendje e njeriut të tillë. Në skajin e dhomës ishte telefoni. Tipi i tillë vrapon në mënyrë të pavetëdijshëm kah telefoni: "Unë jam .. po ti si je. Kam menduar, se fjala ime i takon heshtjes së saj. Zëri i saj ishte i përmbajtur me heshtje. Përderisa zëri i tij po ashtu i përmbajtur dhe përgjigja i tradhtoi, si e ndiejnë veten bashkëfajtor...,

- si shkojnë punët? Përgjigjet.

- Shumë keq. Po ti?

Nuk më pyeti më, se ku jam, prej kah telefonoi, por thjeshtësisht, dëshiron që të shihna. Edhe ata sot, nuk i thash, sepse isha i larguar prej saj vetëm dy hapa. Dhe mendoj, se nga mendjelehtësia nuk do ti themi dot". (C. Castellaneta, Leksikoni i ndjenjave).

Epilogu

Njeriu është krijuar për tjetrin, duke ruajtur identitetin e vet e njëherë duke mos e shkelur tjetrin, apo duke mos e pronësuar atë si mall konsumues. Por, prej dy partnerëve krijohet bashkësia "ne" që i lidh dashuria e pjekur e përgjegjshme. Në këtë relacion krijohet dashuria, e cila është në procesin e zhvillimit nga pjekuria dhe përgjegjësia e plotë.

Një ilustrim figurativ: Ja, këtu është një "unë" dhe ky "unë" takohet me "ty", dhe qëndrojmë së bashku sepse tërhiqemi nga njëri-tjetri, sepse kemi disa gjëra të përbashkëta, dhe nëpërmjet tyre bashkëveprojmë e marrim pjesë te njëri-tjetri. Kjo pjesëmarrje bëhet "ne". Duke vazhduar të ndajmë, të bashkëveprojmë e të shkëmbejmë gjithnjë më shumë ketë "ne", "ti" mbetesh gjithnjë "ti" dhe "unë" mbetem gjithnjë "unë". Nuk zhdukemi kurrë, por zhvillojmë atë "ne" të përbashkët, e cila është lidhja jonë.

Gjatë tërë jetës në bashkësinë martesor duhet ta formoni atë "ne". Pra punoni mbi ketë "ne" që ajo të bëhet gjithnjë më e madhe, por edhe "ti" dhe "unë" të bëhen më të mëdhenj, duke përftuar rrathë koncentrikë shumë të mëdhenj, të cilët zmadhohen pa pushim. Atëherë bashkësia martesore bëhet djepi i mrekullueshëm i përbashkët "ne". Dhe nëse kjo thelbësorja "ne" konsumohet... keni akoma një "unë" dhe kujtimet e shtrenjta që do t'ju shërbejnë për të filluar përsëri.

Mos harroni se jeta në bashkësinë martesore duhet të vazhdoi të rritet, të zhvillohet kah pjekuria dhe përgjegjësia deri në vdekje edhe në pleqëri. Si njëra ashtu edhe tjetra palë duhet të veproi në mënyrë aktive që çdo ditë e re t'ju sjellë diçka të re. Nuk duhet harruar se nuk ka ditë pa natë por as natën pa ditë. Përgjegjësia kryesore e çiftit martesor është për ta harmonizuar ditën dhe natë përkatësisht errësirën dhe dritën (që e bartet në botën e thellësive psike, që di ta shkatërrojë vaporin martesor sado i madh është!) Mos harrohet se nuk jetohet nga e kuluarja, ajo mund të jetë vetëm mësuese e jetës dhe hiç më tepër, dhe mos ta ngarkojmë familjen me thasë e mbushur të kaluarës. Po ashtu mos ta ngarkojmë as me të ardhmen. Por jetohet e tashmja për ta krijuar të ardhmen.

Dr. Don Lush GJERGJI
Prishtinë

OSCAR ROMERO (1917 – 1980), MARTIR I LIRISË DHE DEMOKRACISË

(Fund)

Mons. Oscar Romero udhëton për në Romë dhe paraqet në hollësi gjendjen e rëndë të Kishës në San Salvador. Papa Pali VI e inkurajoi që të vazhdojë rrugën e nisur në mbrojtje të lirisë, derisa institucionet tjera vatikanase ishin pakë më të rezervuara, të shqetësuara për jetën e arqipeshkvit, si dhe për shkak të qëndrimit të ngarkuar dhe të "egër" mes Kishës dhe shteti, kështu që e këshillonin për kujdes më të madh dhe maturi.

Arqipeshkëv i madh për San Salvadorin

Në vitin 1977 Vatikani e emëron arqipeshkëv të kryeqytetit San Salvador, në befasi të të gjithëve, e në veçanti të pushtetit. Përgjegjësia ishte e madhe, shkaku i gjendjes politike e cila u krijua me vite të tëra. Dora e fortë dhe e rëndë diktaturiale nuk e kursente më askënd, po as njerëzit kishtarë e institucionet. Arqipeshkvi tashmë ishte në anën e popullit, me ta ndanë fatin.

Policia së shpejti reagoi dhe e "demaskoi vetveten" me vrasjen e atë Rutili Grande, mikun dhe bashkëpunëtorin shumëvjeçar të mons. Romero-s. Atë Rutili ishte njëri ndër meshtarët më aktiv dhe i dhënë në pastoralin e të rinjve dhe në mbrojtje të lirive të të varfërve. Ishte përcaktuar për parimet ungjillore: të jesh me Krishtin dhe popullin e Zotit deri në vdekje.

Mons. Romero, ishte i goditur thellë, i pikëlluar, i shqetësuar, ndjehej i provokuar të ndërmerrte diçka. Menjëherë protestoi kundër kësaj vepre të keqe dhe kriminale, kërkoi vendosmërisht zbardhjen deri në fund të këtij rasti, i përjashtoi nga Kisha Katolike vrastarët, caktoi tri ditë pikëllimi dhe urate për argijpeshkvinë e tij, udhëhoqi personalisht ceremonitë e varrimit, vendosi për ndërprerje të të gjitha marrëdhënieve me pushtetin deri sa mos të zbulohet dhe dënohet vrastari dhe vrastarët!

Mirëpo, edhe qeveria zyrtare kishte marrë qëndrim të fortë, edhe më tepër përndjekje Kishën, kërcënonte dhe paralajmëronte hakmarrje të reja...

Mons. Oscar Romero udhëton për në Romë dhe paraqet në hollësi gjendjen e rëndë të Kishës në San Salvador. Papa Pali VI e inkurajoi që të vazhdojë rrugën e nisur në mbrojtje të lirisë, derisa institucionet tjera vatikanase ishin pakë më të rezervuara, të shqetësuara për jetën e arqipeshkvit, si dhe për shkak të qëndrimit të ngarkuar dhe të "egër" mes Kishës dhe shteti, kështu që e këshillonin për kujdes më të madh dhe maturi.

Pas një kohe të shkurtër vritet edhe një meshtar dioqezian, Don Alfonso Navaro, në moshë 35

vjeçare, mik dhe mbrojtës i të varfërve. Vdiq si martir i madh i krishterimit, duke iu falur dhe lutur për vrastarët e tij.

Në homilinë e varrimit Mons. Romero ndër të tjera tha: "Ne këtu jemi Kishë e gjallë e cila sjell shpëtimin e njeriut jo vetëm pas vdekjes, por edhe këtu në këtë tokë... Duhet të luftojmë për një shoqëri më humane, kundër dhunës, kundër të këqijave..."

Në angazhimet baritore ai ishte gjithnjë e më i guximshëm, ungjillor, i themeluar në të vërtetën dhe dashurinë, në shërbim. Ja dëshmia e tij mbi Kishën: "Kisha nuk është e lidhur për ndonjë parti apo organizata tjera politike... Pikërisht për atë se është e interesuar për të mira e përgjithshme e njeriut, publikon vlerësimin e gjendjes së vendit, dhe për këtë kërkon mbrojtjen e të drejtave të njeriut... Kisha është renditur në anën e atyre që vuajnë, sepse dëshiron t'ju shërbejë të gjithëve, kështu që nga historia e tyre të arrijnë te historia e shëlbimi... Kjo nuk është marrja me politikë, por ndërtimi i Kishës, përmbushja e detyrave kishtare me fuqinë e identitetit saj... Kisha lufton kundër mëkatit dhe kjo shoqëri duhet dëgjuar mësimin e saj dhe të kthehet për të pasur mundësi të jetë e atillë çfarë kërkon Hyji. Kisha në Salvador është e përkushtuar në mbrojtje të varfërve dhe krenohet me atë që 'përziu' gjakun e meshtarëve, katehistëve dhe bashkësive të saj me gjakun e popullit të masakruar, dhe krenohet që ishte gjithmonë e përndjekur: dhe pikërisht për këtë ajo pengon dhe atë e diskreditojnë, nuk dëgjohet zëri i saj i cili qorton kundër padrejtësive..."

ME POPULLIN DREJT LIRISË

Mons. Oscar Romero gjithë e më shumë bashkohet dhe identifikohet me popullin, apo siç kishte dëshirë të thoshte, "me njerëzit e mi", që t'i udhëhiqte drejt lirisë së vërtetë. E keqja, pushteti, pasuria, dhuna ishin shumë mirë të organizuara dhe të institucionalizuara sikur pushtet apo shtet, një grusht njerëzish që doemos dëshironin për çdo çmim të zotërojnë mbi të gjithë. Ai së bashku me Mons. Rivera Damas-in botërisht e kundërshton pushtetin dhe mundohet të shpëtonte atë që ende mund të shpëtohet. Në vitin 1978 në gjashtë pikë prezanton politikën e cila do të ishte më tepër në shërbim të qytetarëve: pluralizmi politik, pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet e përgjithshme dhe të lira, nderimi i të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut, ndërprerja e urrejtjes dhe persekutimin nga ana e diktaturës, amnistinë për të gjithë të burgosurit politik.

Në ndërkohë, pas vdekjes së befasishme të papës Gjon Palit I ishte zgjedhur papa i ri Gjon Pali II, kardinal nga Polonia komuniste.

Mons. Romero pak ishte i shqetësuar, por prapë pati besim në zgjidhjen e Shpirtit Shenjt. Salvadori, dhe gati se e gjithë Amerika Jugore, atëherë jetonin në kushte mjaft specifike, në frikë nga diktaturat e majta, kumunizmi, derisa në të vërtetë ishin nën diktaturat e rrepta të djathtistëve, të cilat me fjalë paraqiteshin si të krishtera, por me jetë dhe qëndrime ishin tërësisht tjetër. Papa Sllav i njehte shumë mirë dhe personalisht rreziqet nga komunizmi dhe ateizmi shtetëror, mirëpo do duhej të kishte njohuri edhe për varfërinë dhe shfrytëzimin e popullit nga ana e djathtistëve. Pas disa ditëve Mons. Romero i shkroi një letër të gjatë dhe konfidenciale Papës Gjon Palit II mbi gjendjen e Kishës dhe popullit në Salvador.

Papa Gjon Pali II i jep mbështetje të plotë pranisë së Kishës në Amerikën Latine. Në Pueblo më 27 janar 1979 kryeson Konferencën Gjenerale Ipeshkvore të Amerikës Latine, si vazhdimësi e Medellinë-s, por edhe si risi dhe angazhim i Kishës rreth pyetjeve shoqërore.

Martirizimi i Kishës dhe popullit në Salvador vazhdonte. Mons. Romero në paraqitjen publike para Papës dhe ipeshkvijve të Amerikës Latine, para gjithë botës, ashpër dënoi diktaturën ushtarake dhe veprat e këqijat të saja.

Në një rast tha: "Kush e di pse, mirëpo fatkeqësisht është ashtu: fati im është të mbledh 'frytet' e dhunës, trupat e vdekur. Fat i tmershëm, të bartësh në supe barrën e tërë popullit, për çdo ditë të shikosh-jetosh-dëgjosh vetëm rrëfime mbi dhunën, vrasjet, vetëm të ngushëllosh, në pamundësi që të ndërrosh e përmirësosh asgjë!"

Ja dëshmia e çmuar e Mons. Romeros: "Krishterimi është Person i cili më do aq shumë dhe kërkon edhe dashurinë time. Krishterimi është Krishti... Dashuria është përmbledhja e të gjitha ligjeve. Dashuria plotëson të gjitha detyrimet e njeriut...unë e di që ka shumë njerëz që në momentin e tundimit janë frikacakë dhe ikin. Edhe unë frikohem, por jo prej vdekjes, persekutimit, por kam frikë mos ta tradhtojë fenë time, dërgimin tim, Kishën time, popullin tim, mos të dështoj fundi i fundit Zotin dhe dashurinë e tij të madhe... Çdo meshtar që është vrarë, i cili ka vdekur me vdekje martire, gjithmonë është i pranishëm në mendjen,

në zemrën time, e në veçanti gjatë kremtimit të Eukaristisë. Ata janë inkurajim, sepse ditën të vdesin pa patur frikë... Ajo e cila nuk kalon askurrë, është dashuria... Në fund të jetës sate do të gjykohesh në saje të dashurisë..."

"TË GJITHA I LËSHOJ NË DUAR TË ZOTIT"

Arqipeshkvi Oscar Romero gjithë e më shumë ishte i vetmuar dhe braktisur nga të tjerët, mirëpo ka qenë në "shoqëri të mirë" me Jezusin i cili vuan dhe vdes në kryq. Në këto kushte udhëton për në Romë, në Louvain, pastaj në Bruksel, në Paris...Dëshironte të fliste edhe njëherë, t'ju dëshmonte të gjithëve vuajtjen e Krishtit në popullin e tij. Gjithkund ishte i pranuar me nderime dhe popullaritet. Kjo vetëm sa ia shtonte dhembjen e tij që "gati askush nuk po bënë asgjë për 5 milionë salvadorianë, që të kenë mundësi disi të dalin nga ky ferr i padrejtësisë...".

Në një predikim disa ditë para vdekjes ai ndër të tjera tha: "I krishteri gjithmonë duhet të besojë, e të besosh në të vërtetë do të thotë të shpresosh. Ne kemi bërë disa përpjekje që të përmirësohet shoqëria, që të largohen padrejtësisë... Me siguri se Zoti do të shpërblen çdo përpjekje në këtë drejtimi. Ka ende shumë punë. Të gjitha i lëshoj në duar të Zotit!"

Në prag të festës së Lajmërimit, më 24 mars 1980 arqipeshkvi Oscar Romero u përgatiste për kremtimin eukaristike në kapelën e spitalit. Ishte lutja e Mbrëmësores dhe mesha private, ku vijnë aty këtu ndonjë besimtar nga populli. Arqipeshkvi mbajti një predikim të shkurtër, ku ndër të tjera tha edhe këtë: "Askush nuk është përjetësisht i fuqishëm... Sipas besimit katolik e dimë se këtë moment buka do të shndërrohet në Trupin e Zotit tonë, i cili paraqitet për shëlbimin e botës, dhe vera në këtë kelk në Gjakune Tij, i cili qe çmim i shpëtimit tonë..."

Me flijen e Krishtit ka bashkuar edhe ai jetën dhe vdekjen e tij. Nga dora armiqësore arriti plumbi i cili e goditi dhe rrëzoi për toke, të mbuluar në gjak, pranë altarit, gjatë meshës. Ishte ky akti i fundit i dashurisë për Martirin e Amshuar – Jezusin, për Kishën e tij, për popullin e Zotit, për shërbim në dashuri, për falje dhe drejtësi.

U ndal së rrahuri zemra e tij, mbylli sytë, gojën, veshët, u ftoh dhe iu ngurtësuan duart, këmbët... Mirëpo, gjaku i derdhur, jeta e flijuar gjithnjë flasin dhe dëshmojnë edhe më fortë, paralajmërojnë , thërrasin, inkurajojnë dhe presin përgjigjen tonë...

Mons. Romero thoshte kështu: "Unë nuk dëshiroj të jam as 'për' e as 'kundër': thjeshtë dëshiroj të jam ndërtues i kësaj të vërtete të madhe, të vërtetës se Zoti na do dhe dëshiron të na shpëtojë... Nuk mund të ketë dashuri aty ku sundo rrena. Mesit tonë i mungon e vërteta, e kur të thuhet e vërteta, njerëzit ofendohen... Zërat të cilët flasin të vërtetën, heshtin... Sa njerëz do të ishte më mirë të mos thoshin se janë të krishterë, sepse nuk kanë fe. Më tepër i besojnë parave të tyre pasurisë, se sa në Zotin i cili ka krijuar edhe paranë edhe pasurinë... Detyra e jonë primare, thelbësore, është të ndezim dritën e Ungjillit në bashkësinë tonë..."

Zoti "vonon", por nuk harron... Pas viteve të tëra të hulumtimeve, dëshmive, dokumentimeve, së fundi Kisha Katolike në krye me Papën Françesku, nga Amerika Latine, si edhe i Lumi Oscar Romero, më 23 maj 2015, natën e Rrëshajëve, shpallet i Lum, për t'u lutur dhe nderuar në Kishë dhe në botë. Ai ishte dhe mbetet Martiri i lirisë dhe demokracisë, shembull i qartë flijimi dhe dhurimi, guximi, që i vinte nga feja – Jezu Krishti, dhe dashuri – frymëzimi, që e merrte nga prania e Shpirtit Shenjt.



NGRITJA E ZOJËS SË BEKUAR NË QIELL

Një letër armene që i atribuohet Dionisit arepagit, ai përmend ditën e fundit të Nënës se Zotit. Në atë letër të sjell në disa versione gjatë historisë: thuhet në fund të jetës ka ndodhur, "Fjetja" e Marisë në shtëpinë e saj në Efes. Kurse, tradita më e hershëm na thotë se ditët e fundit tokësore Maria i ka kaluar në Jerusalem. Nga shekulli i XII dhe këndej, tradita krishtere është e një mendim se Maria është ngritur me trup dhe me shpirt në Qiell.

Më 15 gusht, Kisha katolike kremton të Ngjiturit e Marisë në Qiell (Zoja e Madhe, Zoja e Grudës, Zoja e Berishës,Zoja Hasit, Zoja e Letnicës,.. etj.) Assumptio Beatae Mariae Virginis.

Ne ketë ditë Kisha na mëson se Virgjëra Mari, Nëna e Jezu Krishtit "e ka përfunduar jetën e saj tokësore, duke u ngjitur me trup dhe me shpirt në lavdinë qiellore."

Kjo doktrinë është përcaktuar në mënyrë dogmatike nga Papa Piu XII më 1 nëntor 1950, në Enciklikën apostolike Munificentissimus Deus. Ndërsa Kishat Ortodokse Lindore besojnë në Fjetjen (dormicion) e Hyjlindëses.

Ky mësim i Kishës mbështetet tek etërit dhe shkrimtarët e Kishës, tek shenjtërit dhe teologët e mëdhenj gjatë shekujve ku shkruajnë dhe pohojnë se Shën Maria Virgjër është ngjitur lumturisht në Qiell.

Shën Epifani (377) i shekullit IV, për Kishën e Lindjes, në shkrimet e tija pohon, se Shën Maria Virgjër është ngjitur në Qiell me trup dhe shpirt. Sipas Shën Epifanit të Salaminës, askush nuk e dinte se Maria kishte vdekur apo jo. Ai është mbështetur në shkrimet apokrife qe kanë qarkulluar nga shekulli i katërt e në vazhdim, si dhe pohimet e kohës së Maria Virgjër Nëna e Jezusit është e ngjitur në qiell.

Madje është i njohur "Liber Requiei Mariae" (Libri, në kujtim të Marisë), i cili mbijetoi i paprekur vetëm në një përkthim Etiopianë. Libri duket se është nga shekulli i IV, kurse tregimi si i tillë i krishterë mund të jetë nga fillim i shekullit të III-të. Gjithashtu tradita shumë e hershme "Gjashtë Librat" bëjnë fjalë për rrëfimet e Fjetjes. Versionet e hershme të këtij apokrifit ruhen në disa dorëshkrime siriane të shekujve 5 dhe 6, edhe pse teksti vetë ndoshta i përket shekullit të 4-t.

Një letër armene që i atribuohet Dionisit arepagit përmend ditën e fundit të Nënës se Zotit. Në atë letër të sjell në disa versione gjatë historisë: thuhet në fund të jetës ka ndodhur, "Fjetja" e Marisë ne shtëpinë e saj në Efes. Kurse, tradita më e hershëm na thotë se ditët e fundit tokësore Maria i ka kaluar në Jerusalem.

Sipas një versionit tjetër i cili ka qarkulluar deri në shekullin e 7-të, në shtëpinë e Marisë ishte i pranishëm njëri prej apostujve, shpesh identifikuar si Shën Toma. Por, sipas versionit

Shën Bernardi (1153) në fjalimet e tija pohon për Virgjërën Mari e cila lumturisht ka hyrë në lavdinë e Qiellit.

Shën Toma i Akvinit (1274) Mëson rreth mëkatit burimor dhe njeriu nder të tjera posedon tri mallkime : Një nga mallkimet qe ishte mëkati i rrjedhshëm,(trashëguar) Maria ishte e kursyer (ishte zënë pamëkatë të rrjedhshëm), dhe si e tillë ajo ngjitet në Qiell.

Edhe Shën Antoni i Padovës (1231), flet për ngjitjen e Virgjërës Mari në Qiell.

Nga shekulli i XII dhe këndej tradita krishtere, është e një mendim se Maria është ngjitur me trup dhe me shpirt në Qiell.

Papa Benedikti XIV në shekullin e XVIII, duke folur për Marinë, pohon se fjetja e saj dhe ngjitja e saj në Qiell është e njëjta gjë.

Po ashtu edhe Koncili i Dytë i Vatikanit, ka diskutuar dhe miratuar mësimet e deritanishëm të Kishës, lidhur me Marinë Virgjër e cila është Ngjitur me trup e me shpirt në Qiell.

Mësimi për mbi Ngjitjen në qiell "assumptio, " të Zonjës Virgjër Mari, u bë i përhapur në të gjithë botën e krishterë, dhe në popull festohej nga shekulli i V-të. Në Lindje këtë festë e ka zyrtarizuar perandori Maurice rreth vitit 600, kurse në Perëndim Papa Sergji I, në shekullin e 8-të. Papa Leoni IV e konfirmon festën e të Ngjiturit e Marisë Virgjër në Qiell si festë zyrtare për mbarë Kishën e Perëndimit dhe kremtohet me 15 gusht.

Për Kishën Anglikane nuk është doktrinë, por 15 gushti është një ditë e shenjtë në nder të Virgjërs Maria. Ndërsa Kisha Episkopale e Skocisë dhe Kisha Anglikane e Kanadasë e shënojnë 15 gushtin si një ditë përkujtimit "Fjetja e së Lumes Zojë". Në Kishën Episkopale në USA është një ditë e shenjtë e "Shën Mërisë Virgjër, Nëna e Zotit tonë Jezu Krisht". Në Kishën e Anglisë me 15 gusht mbahet një Festival i kushtuar se Lumes Zojë.

Në traditën armene, lidhur me festen "Fjetja e Hyj lindëses" është në mes tjerave edhe një porosi kulturore e bekimit të rrushit që fillon çdo vit me 12 gusht.

në fjalë, Toma nuk ishte i pranishëm në (fjetjen) vdekjen e Marisë, por ardhja e tij ne fund të ngjarjes përshpejton rihapjen e varrit të Marisë. Kurse, varri i Marisë me vonë është gjetur i zbrazët (bosh) dhe janë gjetur rrobat e saj të rënda.

Në një traditë tjetër thuhet së: Maria e ka sjell brezin e saj nga qielli në tokë si dëshmi për ngjarjen qe ka ndodhur, se ajo është ngjitur në qiell.

Po ashtu edhe Shën Gregori i Turonit (593) teolog dhe shkrimtar i parë i Kishës se Perëndimit, shkruan se Shën Maria Virgjër është ngjitur në Qiell.

Shën Modesti, patriku i Jerusalemit (634), pohon se nuk është e mundshme që vdekja ta përpijë Nënën e Shpëtimtarit Jezu Krishtit, Zotin tonë, dhënës i jetës dhe pavdekësisë. Krishti vetë u ngjallë, prandaj e ngjall dhe Marinë dhe e merr të vetja…

Shën Germani, patriku i Kostandinopojës (733) shkruan :"Nuk ka mundur ta marrin vdekja atë që ishte Shërbëtorja e Fjalës së Zoti…" Edhe Shën Gjon Damaskut (749), na i ka lënë fjalimet e tija për mbi Virgjërën Mari.

Dr. Tonin ÇOBANI
Tiranë

PESË MUNDIMET E FISHTËS

(Fund)

Poeti Kombëtar në shënjestrën e Salierëve të kohës së vet.

Më parë se ndërkombëtarët të urdhëronin mbylljen e "Hyllit të Dritës" dhe internimin e drejtorit të saj, gazeta "Dielli" e Bostonit (10 mars 1914), boton një shkrim të një anonimi me inicialet E.N. kundër Fishtës ("i dëgjuari vjershëtor shqiptar"), për të cilin i ka ardhur shumë ligsht ("na ardhi shumë likësht") sepse ai shkruan në revistën "Hylli i Dritës", sipas tij, "vegël fetare e Vatikanit të Romës".

Një frat shqiptar internohet në Maltë

Ndëshkimi i tretë i vjen Fishtës nga ndërkombëtarët. Ky ndëshkim është bërë i njohur qysh herët prej biografit të parë të tij, Pashko Bardhit. Ky frat, bashkëstudent i Fishtës qysh në seminarin e Troshanit, shpjegon se revistës së themeluar prej Fishtës, "Hyllit të Dritës", iu desht me u ndalë së botuemi" pa mbushur as një vit nga numri i parë. Pikërisht në këtë kohë doli vendimi edhe për dëbimin nga Shkodra të drejtorit të saj. Marin Sirdani, një tjetër frat, bashkëpunëtor i afërt i Fishtës, shkruan se "qeveria internacionale" e kishte paditur Fishtën në Romë "si njer(i) të rrezikshëm për qetësin(ë) e vendit".

Disa thonë se mbyllja e revistës dhe dënimi me internim i drejtorit të saj erdhi për shkak të shkrimeve të Fishtës në atë revistë. Përmendet, veçanërisht artikulli me titull "Një komedi e pandershme e qindvjetit XX" (Hylli i Dritës, 1914\10), ku akuzohen ballazi Fuqitë e Mëdha për mos vëmendje ndaj Shqipërisë. Por është edhe flamuri gjashtëmetrosh, i kuq me shqiponjën e zezë dykrenore, në majën e kompanjelit të Kishës Françeskane, ngritur nga Fishta mbas largimit të trupave pushtuese malazeze, pa marrë më parë leje nga forcat shumëkombëshe që qeverisnin qytetin. Është dëgjuar edhe një himn kombëtar, që fillon me vargun "Porsi fleta e Ejllit të Zotit" (teksti i Fishtës dhe muzika e Lec Kurtit), i cili këndohej nëpër rrugët e rrugicat e Shkodrës nga nxënësit e shkollës françeskane. Të gjitha së bashku e, ndoshta, ndonjë tjetër e përgatiten dëbimin e tij prej Shkodrës.

Ekslokimi i ka ardhur prej guvernatorit të atëhershëm të Shkodrës, kolonelit anglez Filips, i cili formulon urdhrin për ta internuar Fishtën 20 muaj në Maltë. Urdhri doli, por Fishta i shpëtoi këtij mundimi vetëm duke u largua më parë se të vinin për ta arrestuar ushtarët e huaj: ai u strehua në seminarin e Troshanit e në famullinë e Gomsiqes (ku aso kohe shërbente Gjeçovi), të Vigut (Pashk Bardhi) dhe Rubikut (Pal Dodaj). Fatmirësisht vendimi i ndërkombëtarëve nuk kishte fuqi përtej Shkodrës me periferi deri në 10 km.

Pyetja që na vjen menjëherë ndër mend është: si mundet një frat të ishte njeri i rrezikshëm për qetësinë e qytetit të vet, të mbrojtur nga ndërkombëtarët? Asnjëri prej arsyetimeve të dhënë deri sot nuk e justifikojnë dënimin me internim të një kleriku, i cili, vetëm për faktin se është i paarmatosur, është i papërfillshëm për ushtarakët. Por mua më kanë ardhur në ndihmë studimet e dhjetëvjetëshit të fundit të Paolo Muner-it. Prej tyre kam krijuar një tablo të gjallë për atë çfarë mund të ketë ndodhur në Shkodër në atë kohë, duke u bindur në formulimin e një arsyetimi që gjithnjë e më tepër po më lidhet me një farë tendence në vijimësi për ta kundërvënë Fishtën me lexuesin e vet, ashtu si të gjithë shqiptarët "me i përzi" njërin kundër tjetrit.

Më parë se ndërkombëtarët të urdhëronin mbylljen e "Hyllit të Dritës" dhe internimin e

drejtorit të saj, gazeta "Dielli" e Bostonit (10 mars 1914), boton një shkrim të një anonimi me inicialet E.N. kundër Fishtës ("i dëgjuari vjershëtor shqiptar"), për të cilin i ka ardhur shumë ligsht ("na ardhi shumë likësht") sepse ai shkruan në revistën "Hylli i Dritës", sipas tij, "vegël fetare e Vatikanit të Romës". Ndërkohë që Paolo Muner-i në një varg studimesh, që kanë për objekt Shkodrën e atyre viteve, na ballafaqon me një realitet krejt tjetër. "Këtu,- shkruan ai duke paraqitur konkluzionet e Carlo Galli-t, në atë kohë Konsull i Përgjithshëm Mbretëror i Italisë në Shkodër,- del në pah një nga aspektet më të çuditshme të situatës; konkurrenca mes Austrisë dhe Italisë bëhet "në lëkurë" të shkodranëve, dhe përfshin gjithashtu anën fetare: Austria ishte prej kohësh shtet mbrojtës i katolicizmit , edhe pse ky rol fillonte të luhaste, ndërsa Italia, akoma vend laik, ku Papa madje konsiderohej "i burgosur politik" , filloi të hahej me të në këtë fushë." Dhe unë dua të mbetëm veçse te shprehja "në lëkurë të shkodranëve", sepse pikërisht këtë "lëkurë" apo "nënlëkurë" e ndiejnë më dhimbshëm shkrimtarët, prandaj ua ndalin dorën (mbyllja e revistës) dhe ua kyçin gojën (internimi në Maltë).

Sa vlen një nënkryetar parlamenti?

Gjatë kohës kur Fishta ishte deputet, madje, deri nënkryetar i Parlamentit, realizon një vizitë në SHBA. Në Tiranë ndodh çudia. Në gazetën zyrtare "Dita e Re"(26 prill 1922) nën okelion "Në Këshillin e Kombit" del një njoftim me titull "At Gjergj Fishta s'ka ndonjë mision", "prandaj të gjithë thëniet e tij ndër qarqe apo shoqëri të çdo lloji që të jenë, nuk kanë asnjë frymë zyrtare e janë fjesht private e personale d.m.th., pjellat e mendimit të tij privat e personal". Njoftimi është firmosur nga kryetari i Këshillit Kombëtar, z.Eshref Frashëri, d.v.

Me 9 maj 1922 gazeta "Posta e Korçës" e riboton këtë lajm duke shtuar se z.Eshref Frashëri e trajton "atdhetarin shkodran (dhe) shkrimtarin nga më të fortët të Shqipërisë" sikur të ishte një vagabond. Këndej zemërohet Konica, i cili boton te gazeta "Dielli" shënimin me titull "Sistemi oriental"(26 qershor 1922). Ai përballë "ndershmërisë së Fishtës" vë atë që me gjuhën e sotme nënkupton fjalën "dekriminalizim" të Parlamentit dhe Qeverisë, pra, "trurin anadollak, (të cilit) i duket vagabond njeriu i ndershëm, njeriu i sinqertë, ay që del sheshit dhe të kritikon". Këndej Fishta ngjesh pendën e tij dhe boton po në gazetën "Dielli", që aso kohe drejtohej prej vetë Konicës, atë të famshmen, "Letër e hapun..."(8 korrik 1922), kundër Eshref Frashërit, shkrim i cili ka mbetur model i polemikës në letrat shqipe.

Po ç'ne ky ndëshkim në distancë i Kryetarit të Këshillit Kombëtar? Përse kërkojnë ta përjashtojnë poetin prej kontributit kombëtar?

E vërteta është se Fishta udhëtonte në SHBA me qëllim grumbullimin e ndihmave për ngritjen e liceut françeskan të Shkodrës, ndër më të parat shkolla të mesme të këtij lloji në vendin tonë. Pavarësisht kësaj, ai në çdo rast do të kontribuonte, siç kishte vepruar gjithmonë, për çështjen kombëtare. Dhe, nëse për liceun nuk bëri ndonjë gjë për t'u shënuar, për çështjen kombëtare bëri, dhe bëri shumë, madje. Ai loboi tek senatorët katolikë të Washingtonit për njohjen e Shqipërisë prej SHBA-së. Dhe ia arriti qëllimit. Mori përgjigje se njohja u krye.

Është një fakt ky që duket si rastësi. Por jo. Sigurisht unë nuk mendoj se po të mos shkonte Fishta (pa lejen e Eshref Frashërit) në SHBA, kjo e fundit nuk do ta kishte njohur ndonjë herë Shqipërinë apo, së paku, nuk do ta kishte njohur edhe për një kohë të gjatë, ndoshta, për një vit a gjashtë muaj. Jo. Jo. Por lobimi i Fishtës gjeti rrugë, ndoshta më shpejt se të tjerë shqiptarë patriotë kishin tentuar ta kryenin deri atëherë. Ja si i shkruan Fishta Pal Dodës: Këtu në Wshington kam kontaktuar me një senator katolik, siç të kam shkruar (29.4.1922) dhe i jam lutur të interesohej pranë Qeverisë së tij për njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur... Ai ka folur me senatorin Lodge dhe sot më tha se njohja e Shqipërisë është e mundshme, prandaj Qeveria e Tiranës ta paraqesë kërkesën e saj me shkrim në Nënsekretariatin e Shteteve të Bashkuara... (Washington, 8 maj 1922).

Ajo çfarë vijon në letrën e Fishtës më ka cimbisur sa herë e kam lexuar, sepse më vjen si një dhimbje universale për ne shqiptarët. Fishta ka problem kryeministrin shqiptar, Xhafer Ypin, ministrat Ahmet Zogun e Spiro Kolekën e të tjerë, për të cilët i lutet Pal Dodës të ndërhyjë, pra, në një farë mënyre të futet mik për t'ia dërguar atë kërkesë formale Departamentit përkatës të Qeverisë Amerikane. Edhe sot, më duket mua, është më lehtë të binden të huajt për nevojat që ka populli shqiptar se sa vetë deputetët e pushtetarët shqiptarë, të votuar prej vetë shqiptarëve: prandaj ka qenë vënë në shënjestër herë pas herë Fishta, ashtu siç ka tendencë sot të ekskomunikohet edhe vepra fishtjane, së paku, leximi i saj.

Një emigrant politik me veladon

Në periudhën 1920-1924 Fishta merr pjesë aktive në politikë. Mund të sjellim si shembull këtu esenë "Shqiptarët dhe të drejtat e tyne" (1920), që u shkrua në Paris ndërsa ishte sekretar i delegacionin zyrtar të Shqipërisë në Konferencën e Paqës, prandaj është quajtur edhe Eseja e Parisit; të përmendim

botimin e tragjedisë "Juda Makabe"(1920 dhe 1924), e cila sa herë që u vu në skenë provokoi pështjellime ndër protagonistë të kohës, si dhe poemën "Gomari i Babatasit"(1923), që në vetvete ishte më shumë se provokim.

Fishta ishte në opozitë së bashku me Gurakuqin, Nolin, Mjedën dhe të tjerë. Kujtojmë këtu dy proza: ligjëratën "Fjala e Pater Gjergj Fishtës në vdekje të Avni Rustemit" dhe esenë "Trazimet e qershorit 1924". Prandaj kur ra qeveria e Nolit, Fishta, i këshilluar nga disa miq të vet, siç thuhet, u largua nga Shqipëria dhe nuk u kthye derisa miq të tjerë të fuqishëm e siguruan se nuk rrezikohej seriozisht nga Zogu. Madje duket (ky është thjesht opinion personal) se edhe ai premtoi në një farë mënyre se nuk do të merrej më seriozisht me politikë. Dhe ashtu bëri. Kishte kaluar çaste edhe më të vështira, sesa të hiqte dorë nga politika: ishte detyruar të arratisej për shkak se i rrezikohej jeta sikundër mikut të tij, ndër më të mirët, Luigj Gurakuqit, në varrimin e të cilët nuk ishte lejuar as të bënte një kryq e jo më të mbante një fjalim të merituar, siç ai dinte të bënte.

Disa studiues të sotëm kanë tendencë për ta anashkaluar opozitarizmin e Fishtës. Kjo është baras sikur të kërkosh ta tredhësh Poetin. Daniel Gjeçaj, biografi më i plotësuar i Fishtës, ka dëshmuar se Fishta "ndeji i mërguem në Itali". Ai ka përshkruar me detaje edhe shkatërrimet që pësoi liceu "Iliricum" i Shkodrës prej trupave qeveritare, të cilët kishin ngritur aty shtabin e tyre për të nënshtruar kryengritjen e Dukagjinit të vitit 1926 (20 nëntor). Gjeçaj ka qenë seminarist në moshë të vogël, "por jo aq, sa mos me kuptue psehin e ngjarjeve",- shkruan ai. Dhe vazhdon duke përsëritur fjalët që dëgjoheshin atëherë nga krerët e kuvendit: "shyqyr që nuk është Fishta në Shqipëri", ndërsa një pjesë e fretërve si Pater Anton Harapi e Atë Çiril Cani ishin të arrestuar dhe kërcënoheshin deri me dënim kapital.

Përmbyllje

Ndëshkimet e Fishtës kanë synuar ta kundërvënë Poetin me lexuesin e vet, ashtu si ndodhi gjatë periudhës së qeverisjes ideologjike e vazhdon deri në ditët e sotme, kur dëgjojmë: Fishta është shkrimtar i madh, por ka edhe njolla; është përfshirë tashmë në tekstet shkollore, por është kaq i vjetruar, sa s'ia vlen; ka shkruar shumë vepra (edhe kryevepra), por vetëm për gegët? Mendoni se si do të ishte bota nëse italianët do të gjykonin kështu Danten e tyre për shkak të gjuhës së tij, tashmë tepër të vjetruar e në dialektin e një qyteti a krahine të Gadishullit të Apeninëve; nëse anglezët do të silleshin po ashtu me Shekspirin, spanjollët me Servantesin e me radhë: gjuha e të gjithë këtyre tashmë vërtet është e vjetruar për brezat më të rinj.

Çdo kundërvënie me lexuesin është më e rëndë se distancimi i një kleriku me besimtarët e vet apo i një mësuesi/edukatori me nxënësit e tij, sepse në rastin e klerikut apo të edukatorit kundërvënia është me një grup të kufizuar besimtarësh a studentësh. Ndërsa në rastin e shkrimtarit me lexuesin e tij kundërvënia është e përmasave të pallogaritshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për shkrimtarë të nivelit të Gjergj Fishtës, vargjet e të cilit mësoheshin përmendsh edhe kur vepra e tij përbënte fajësi të dënueshme për agjitacion e propagandë edhe thjeshtë për faktin se dikujt i gjendej si libër në bibliotekën vetjake.

Por autori i Lahutës së Malcis rrezatonte ngado energji pozitive jo vetëm si poet, por edhe si predikues, drejtor shkolle dhe veprimtar politiko-shoqëror. Prandaj kundërvënia e Fishtës me popullin e vet bëhej jo në mënyrë sporadike. Nuk mund të pohohet me plot gojë që të ketë pasur ndonjë strategji për të shmangur ndikimin e veprës fishtjane ndaj lexuesve, ndaj shqiptarëve bashkëkohës e të mëvonshëm, deri në ditët e sotme. Por mund të numërohen episode pa fund intrigash, poshtërsish, mbrapshtish, siç i quan Fishta mundimet e veta, që e kanë ndjekin nga pas gjatë gjithë jetës, së paku, nga koha kur ka qenë student në dhe të huaj e deri në sekondat e fundit të jetës kur disa prej atyre që i rrinin te koka seleksiononin porositë e tij për të mos mbetur ajo që të rinjtë e kohës kishin formuluar për Poetin Kombëtar: "Nuk më vjen keq se po shkoj, por se po e lë vendin të pushtuar."

Ilirjana Koleka
Tiranë

KONGRESI I PARË I MANASTIRIT (14-22 NËNTOR 1908)

(Fund)

Kongresi i parë i Manastirit (apo Kongresi i Alfabetit) është tubimi i dijetarëve shqiptarë më 14 - 22 nëntor 1908, në Manastir, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Kontributi i Skënderbeut dhe Ali Pashë Tepelenës për shndërrimin e Manastirit në qendër vilajeti dhe në vendlindje të Alfabetit.

Zanafilla e Kongresit i Manastirit ose fillimi i kësaj rruge është mjaft i gjatë, por fillojmë nga koha e Skënderbeut e këtej. Kongresi i parë i Manastirit nuk do të ndodhte sikur ky qytet mos të ishte qendër vilajeti, e, për këtë, në mënyrë indirekte ka kontribuar edhe rezistenca e shqiptarëve, duke filluar nga koha e Skënderbeut. Pushtuesit osmanë, me të shkelur në Manastir, patën shqetësime të mëdha pikërisht nga rezistenca në fjalë, me në krye heroin tonë kombëtar. Ky, përveç asaj që ka dashur Manastiri, themeluar nga stërgjyshërit e tij – Linkestët, mos mbetet në duart e osmanëve, deshi të hakmerret edhe për helmimin e vëllezërve të vet nga ana e sulltanit. Ky i fundit, i vetëdijshëm që me forcë nuk do mund të përballojë dot Skënderbenë, trimërinë e të cilit e kishte njohur derisa e kishte peng, vendosi ta qetësojë përmes islamizimit të shqiptarëve. Për ta kryer këtë, patjetër duhej të ngriheshin objekte fetare islame në Manastir. Prandaj, nuk ishte gjë e rastit që xhamia e parë në Ballkan u ngrit pikërisht në këtë qytet dhe atë, me iniciativën e një komandanti të shquar turk, i cili posa ishte kthyer nga një betejë e pasuksesshme me shqiptarët e Skënderbeut, vetëm disa vjet pas vdekjes të këtij të fundit. Pas xhamisë së parë, filluan të ngrihen edhe të tjera, numri i të cilave, në fund, arriti në 72, gjë që e shndërroi Manastirin në qendrën më të rëndësishme dhe më atraktive fetare në Ballkan. Për këtë pra, në mënyrë indirekte, ka kontribuar edhe Skënderbeu dhe rezistenca shqiptare në përgjithësi.

Nga kjo që theksova më sipër del përfundimi se shqiptarët pushtetin osman e rezistonin më tepër se çdo popull tjetër që jetonte në Manastir. Me të drejtë, ndonjë nga lexuesit do të dojë të dijë shkaqet për këtë. Përgjigja ime do të ishte kjo. Historia ka dëshmuar se ai që ruan pragun e shtëpisë së tij, reziston më tepër nga mysafiri. Nëse këtë shtëpi rastësisht e përfshin zjarri, mysafiri do dalë prej saj, për të shpëtuar jetën, kurse i zoti qëndron deri në fund dhe bën çmos për ta shuar zjarrin, duke sakrifikuar jetën. Ose, për ta elaboruar më mirë këtë, do shërbehem me një shembull mjaft të thjeshtë, por me plot kuptim. Nëse një fëmijë mban në dorë para të veta, vështirë është që t'ia marrish, e nëse ato para i ka të vjedhura, menjëherë t'i jep dhe ia mbath këmbëve, sepse s'i ka fituar me djersë. Besoj se u kuptuam. Por, le t'i kthehemi Skënderbeut. Manastiri, përveç se ishte një qendër fetare, më vonë, u bë edhe qendër ushtarake. Rezistenca e Skënderbeut dhe e shqiptarëve pas vdekjes së tij, kontribuoi tepër në këtë drejtim sepse, edhe pse një pjesë e madhe e shqiptarëve, për t'i shpëtuar asimilimit të egër sllav, përqafoi islamizmin, nuk e pranuan sundimin osman, kështu që, rezistenca shqiptare nuk u ndërpre. Kjo e detyroi sulltanin të sjellë forca të mëdha ushtarake, për nevojat e të cilëve u ngritën objekte të ndryshme ekonomike etj., në Manastir, të cilat këtij qyteti ia ndryshuan krejtësisht tiparet ose fizionominë, duke e shndërruar në qendër vilajeti dhe në qytet konsujsh, gjë që, mundësoi që Manastiri të shndërrohet edhe në Qendër të Lëvizjes Mbarëkombëtare Shqiptare, me vepra të shumta atdhetare, siç është edhe Kongresi i Alfabetit.

Në këtë drejtim, ka kontribuar edhe Ali Pashë Tepelena. Ky, si kundër Skënderbeu, përveç që ka dashur Manastiri, si vatër e vjetër ilire, që të mos mbetej nën turqit, hakmerrej edhe për vrasjen e vjehrrit të tij, Kapllan Pashës, të cilit, akoma pa zbritur nga kali, ia prenë kokën dhe e lanë në atë gjendje të mjerueshme disa ditë me radhë në një shesh të Manastirit. Kontributi i Ali Pashë Tepelenës për afirmimin e Manastirit, ka të bëjë edhe me vllahët. Ai, siç dihet, dogji Voskopojën dhe disa vende të tjera, jo

për t'i plaçkitur, siç thonë kundërshtarët e tij, por për t'ia shkulur rrënjët e propagandës greke. Kjo djegie bëri që shumë familje vllahe nga ato vende, të shpërngulen në Maqedoni, pra edhe në Manastir. Këta vllahë, njihnin nga disa gjuhë dhe zanate dhe si të tillë i dhanë impuls të veçantë zhvillimit ekonomik, gjegjësisht tregtisë dhe zejtarisë, gjë që edhe më tepër i hapi rrugën Manastirit për t'u shndërruar në qendër vilajeti, pa të cilin nuk do të mbahej dot Kongresi i Alfabetit. Ja pse, Manastiri, si qendër e rëndësishme ekonomike, u mundësoi disa familjeve shqiptare, të pasurohen dhe një pjesë të pasurisë ta shfrytëzojnë në dobi të veprave kombëtare, siç ishte edhe Kongresi i Manastirit. E them këtë, sepse ky kongres zgjati rreth 10 ditë dhe kërkonte shpenzime të mëdha, të cilat ranë kryesisht në kurriz të familjeve të pasura, siç ishin ajo e Gërmenjëve, në hotelin e të cilëve – "Liria", u mbajt kongresi në fjalë, si dhe ajo e Qiriazëve, familja më patriotike në mbarë kombin shqiptar dhe në të gjitha epokat pas asaj të Frashëllinjëve, prej të cilës fitoi frymëzimin e saj kombëtar dhe atdhetar.

Kësaj familjeje, gjegjësisht, rolit të saj në Kongresin e Alfabetit, i është kushtuar vëmendje e veçantë. Prandaj, në këtë rast, do theksoj vetëm disa momente më kryesore. Kjo familje përbëhej prej 5 anëtarëve, 3 meshkujve dhe 2 femrave, secili më patriot se tjetri. Për këtë ka kontribuar, siç thamë, familja e Frashëllinjëve, posaçërisht bilbili i gjuhës shqipe – Naim Frashëri. Ky, veç tjerash, i ka mundësuar Sevasti Qiriazit, të kryejë me sukses dhe në kohë fakultetin e mësuesisë në Stamboll dhe gjatë ceremonisë së diplomimit, i dha porosi të tilla kombëtare, të cilat ajo i respektoi dhe i realizoi në maksimum. Sevastia dhe motra e saj Parashqeva, njihnin nga 8 gjuhë dhe si të tilla ishin femrat më të emancipuara në Ballkan, kurse e dyta ishte e vetmja femër në botë, në Konferencën e Paqes në Paris, më 1919-1920. Librat e Naim Frashërit ishin pasuria më e madhe e familjes Qiriazi. Nga shkrimet e tij ishte frymëzuar sidomos Gjerasim Qiriazi, gjë që shihet edhe në vjershat e tij, siç ishte edhe strofa në vijim:

Do punoj për mëmëdhenë,
gjithë jetën sa të roj,
do t'i zgjoj edhe ata që flenë,
kështu jetën ta mbaroj.

Patriotizmi i Naim Frashërit kishte frymëzuar edhe nënën e Qiriazëve, e cila, edhe pse e pashkolluar, kontribuoi tepër në shkollimin e fëmijëve të saj dhe e cila nuk lejonte që në shtëpinë e saj të flitet gjuhë tjetër përveç shqipes, kështu që aty hynin e dilnin vetëm patriotë të shquar, posaçërisht para, gjatë dhe pas Kongresit të Manastirit. Në shtëpinë e saj mbaheshin mbledhjet e fshehta që kishin të bënin, jo vetëm me Alfabetin, por edhe me çështjen e çlirimit të vendit nga sundimi pesë shekullor osman. Për Qiriazët, e zgjata një çikë më tepër, për të konstatuar se pa këtë familje Manastiri nuk do të bëhej dot qendra e Lëvizjes Kombëtare, pra, as edhe vendlindje e Alfabetit shqiptar. Në oborrin e kësaj familjeje, u ngrit edhe Shtypshkronja Universale Shqiptare. Për ngritjen e saj u vendos në Kongresin e Manastirit. Nga kjo shtypshkronjë dolën 300 tituj të shkrimeve, librave, abetareve dhe publikimeve të ndryshme shkencore etj., në 13 gjuhë të botës të cilat shpërndaheshin në të katër anët e rruzullit tokësor, gjë që çështjen shqiptare e afirmoi tepër në tërë anët e Globit dhe hapi rrugën drejt Pavarësisë së Shqipërisë. Pikërisht këtu qëndron roli i familjes Qiriazi dhe i Kongresit të Alfabetit, në të cilin, siç thashë, ra vendimi për ngritjen e Institucionit në fjalë.

Kongresi i Manastirit ishte urë midis Lidhjes së Prizrenit dhe Pavarësisë së Shqipërisë. Sepse, në Lidhjen e Prizrenit të v. 1878, u aktualizua nevoja e aprovimit të Alfabetit të përbashkët. Prandaj, jo rastësisht, vetëm disa muaj pas kësaj, gjegjësisht gjatë vitit 1879, u krijua Alfabeti i Stambollit, i njohur edhe si Alfabeti i Sami Frashërit, sepse ky me duart e veta i krijoi germat e atij Alfabeti, i cili u vlerësua lart në Kongresin e Manastirit. Ndërsa, lidhja e Kongresit me Pavarësinë e Shqipërisë qëndron në faktin që para këtij kongresi, shqiptarët përdornin alfabete të ndryshme, të cilat, jo vetëm që pengonin komunikimin normal midis tyre, përmes letrave, por shkaktonin edhe grindje, sepse bihej nën ndikim të vendeve nga të cilat fitohej alfabeti. Me aprovimin e Alfabetit të Manastirit, pengesat në fjalë si dhe grindjet, morën fund, gjë që hapi rrugën e trazuar nga Lidhja e Prizrenit drejt Pavarësisë së Shqipërisë, e cila u realizua në të njëjtin muaj, pas 4 vjetësh nga Kongresi i Manastirit, më 28 nëntor, 1912.

Me siguri, lexuesve do t'iu interesojë se si ishte atmosfera para objektit të Alfabetit ditën e fillimit. Ishte 14 nëntori 1908. Dëbora kishte mbuluar Pelisterin piktoresk dhe kulmet e shtëpive të Manastirit. Megjithatë, qysh në orët e para të mëngjesit, para objektit ishin grumbulluar qindra shqiptarë e të tjerë, të cilët të ftohtin e përballonin përmes këngëve dhe valleve kombëtare, gjë që krijonte përshtypjen sikur aty bëhet ndonjë dasmë e madhe shqiptare. Para objektit, në të dy anët e Dragorit, ishin mbledhur edhe më tepër se 100 nxënës shqiptarë të cilët mësonin në shkollat e mesme, sidomos në Gjimnazin turk të Manastirit që ndodhej pranë objektit të Kongresit. Në atë gjimnaz kishte edhe 4-5 profesorë shqiptarë, midis të cilëve edhe Bajo Topulli, zëvendës drejtor i atij institucioni arsimor. Këngët dhe vallet pushuan në momentin kur filluan të vijnë kongresmenët, të cilët ishin ajka e kombit të atëhershëm shqiptar, siç ishin: Mit'hat Frashëri – kryetar i kongresit, kurse më vonë edhe i Ballit Kombëtar, Gjergj Fishta – "Homeri shqiptar", Luigj Gurakuqi, Shain Kolonja – dhëndër i Naim

Frashërit etj.. Përqafimet dhe lotët nga gëzimi nuk kishin fund. Interesant ishte fakti që midis kongresmenëve kishte myslimanë, të krishterë, synitë, bektashinj, ortodoksë, katolikë, prtotestantë, toskë, gegë, çamë, labë etj.. Prandaj edhe para objektit ishin të pranishëm njerëz pothuajse të tëra konfesioneve në fjalë. Pas kësaj ceremonie madhështore, njerëzit u kthyen nëpër shtëpitë e veta duke pritur padurim epilogun, kurse pjesëmarrësit e Kongresit hynë në sallën e madhe, e cila sot nuk ekziston më dhe pas disa mbledhjeve të njëpasnjëshme, aprovuan Alfabetin. Kështu që, kongresmenët, të shprehem në mënyrë figurative, luajtën rolin e krushqve, të cilët nga ky objekt, gjegjësisht nga Manastiri, morën "nusen" më të mirë, e cila rreth një shekull po i shërben dhe sa të jetë bota do t'i shërbejë tërë shqiptarëve kudo që kanë jetuar dhe do jetojnë paskëtaj.

Siç dihet, Kongresi i Manastirit nuk do të ndodhte pa Hyrijetin. Shtrohet pyetja: Pse këtë ngjarje e përfituan më tepër shqiptarët, e jo edhe popujt e tjerë. Përgjigja është kjo. Revolucionin xhonturk që solli Hyrijetin, e filloi dr. Ibrahim Temo nga Struga në Stamboll, kurse e realizoi bashkatdhetari i tij – Nijazi Be Resnja më 1908 në Manastir. Pra, pa shqiptarët, nuk do të ndodhte Hyrijeti. Xhonturqit, të cilët u kapardisën në krye të shtetit, ishin të vetëdijshëm për këtë, prandaj s'kishin guxim as edhe fytyrë që të pengonin Kongresin e Alfabetit, edhe pse ky ishte në dëm të Perandorisë osmane, sepse zëvendësoi alfabetin e mëparshëm, turko-arab, dhe krijoi kushte për Pavarësinë e Shqipërisë, gjegjësisht për ndarjen e këtij shteti nga Turqia.

Historia e Manastirit është e pasur me plot ngjarje të lavdishme për popullin shqiptar. Por, çka mbetur sot nga kjo histori në këtë qytet? Asgjë. Nga Shtypshkronja Universale s'ka as nam as nishan, edhe pse ajo ka afirmuar tepër emrin e këtij qyteti . Sikur të ishte vepër e ndonjë maqedonasi, kushedi se çfarë përmendoreje do të vendosej aty. Madje, as emrin e ndonjërit nga 5 anëtarët e familjes Qiriaze ku u ngrit ajo shtypshkronjë nuk e ka marrë, të paktën ndonjë rrugicë e qytetit. Objekti ku u mbajt Kongresi është në ditë të hallit, gabim ky që duhet të korrigjohet, sidomos tani kur po bëhen përgatitje për manifestimin e 100-vjetorit. Ajo që ka mbetur si gjurmë, të cilën autoritetet albanofobe s'kanë mundur ta zhdukin, është emri i fushës së Pellagonisë, që kujton Pellazgët e para 12.000 viteve të kaluara, Heraklea Linkesits, që kujton fiset ilire – Linkestët dhe Bardhylin, emri i lumit Dragor, që ka të bëjë me fjalën shqipe dragua, si dhe emri sllav i Manastirit – Bitolla, që ka të bëjë me fjalën shqipe i butë. Sikur këto sqarime t'i dinin autoritetet serbe dhe komuniste maqedone, me siguri do tua ndërronin emrin.

Fjalori ku u mbështet puna e Kongresit të Manastirit

"Fialuer i Rii i Sheypes" , bazë e gjuhës së sotme shqipe

Alfabeti i sotëm u udhëhoq nga parimi i zbatuar në alfabetin e shoqërisë "Bashkimi", i përfaqësuar nga At Gjergj Fishta, në përdorimin e dyshkronjëshave, që patjetër ka luajtur rol vendimtar. Ky fjalor gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Maqedonisë.

Në prag të aktiviteteve për 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit, historiani Skënder Asani nga arkivi i Bibliotekës Kombëtare të Maqedonisë ka zbuluar një fjalor të vjetër të gjuhës shqipe nga Shoqëria "Bashkimi" e Manastirit, e cila që në janar të vitit 1908 ka përpiluar një fjalor të gjuhës shqipe e cila edhe sot është në përdorim nga shqiptarët. "Fialuer i Rii i Sheypes" i Shoqërisë "Bashkimi" deri më sot është i pa botuar thekson Asani, ndërsa, sipas tij, tregon rëndësisë e Shoqërisë "Bashkimi" për organizimin e Kongresit të Manastirit por edhe për unifikimin e gjuhës shqipe. Duke u futur në histori, Asani shpjegon se formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar (gjuha standarde), si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, ka qenë një proces i gjatë, që ka filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i saj hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare. " Në programin e Rilindjes, mësimi dhe lëvrimi i gjuhës amtare, përpjekjet për

pasurimin e saj dhe pastrimin nga fjalët e huaja dhe të panevojshme, zinin një vend qendror. Gjatë kësaj periudhe, u zhvillua një veprimtari e gjerë letrare, kulturore dhe gjuhësore. Shoqëria 'Bashkimi' i vuri vetes disa objektiva për të realizuar. Për kohën kur u themelua, çështja më thelbësore ishte zgjidhja e problemit të alfabetit të njësuar në gjuhën shqipe. Alfabeti i Stambollit, i krijuar më 1879, ndonëse në fillim entuziazmoi shumë shqiptarë, më pas jehona erdh e u zbeh, duke e kufizuar rrezatimin e tij. Përveç kritikave, disa organe që botoheshin jashtë Shqipërisë në gjuhën shqipe, jo vetëm e ngritën përsëri këtë problem, duke e konsideruar të pazgjidhur çështjen e alfabetit të gjuhës sonë e duke mos pranuar atë alfabet që miratoi shoqëria e Stambollit, por hartuan edhe variante të reja që rritën numrin e alfabeteve të shqipes", thekson Asani.

Hapi i parë i Shoqërisë "Bashkimi"

Sipas tij nga Shoqata "Bashkimi" u bë hapi i parë për hartimin e një fjalori kombëtar të gjuhës shqipe, që është "Fialuer i Rii i Sheypes" "Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, u përvijuan dy variante letrare të kombit shqiptar, varianti letrar jugor dhe varianti letrar verior. U bënë gjithashtu, përpjekje për afrimin e këtyre varianteve dhe për njësimin e gjuhës letrare. Detyra e parë që duhej zgjidhur, ishte njësimi i alfabetit. Deri atëherë, shqipja ishte shkruar në disa alfabete: alfabeti latin, alfabeti grek, alfabeti turko-arab dhe alfabete të veçanta. Këtë detyrë e zgjidhi Kongresi i Manastirit, i mbledhur më 14 deri më 22 Nëntor të vitit 1908, në qytetin e Manastirit", thekson Asani i cili shton se "në këtë Kongres, pas shumë diskutimesh, u vendos që të përdorej një alfabet i ri, i mbështetur tërësisht në alfabetin latin që është përdorur edhe në "Fialuer i Rii i Sheypes" nga Shoqata "Bashkimi". Sipas historianit Asani, në këtë periudhë parapëlqehej më shumë mbështetja në alfabetin latin, alfabet të cilin e zbatonte Evropa e qytetëruar, por edhe pse kishte disa përparësi, kryesisht të karakterit praktik. "Në këtë alfabet u mbështet edhe shoqëria 'Bashkimi', duke pasur si parim që një tingull - fonemë mund të paraqitej edhe me dy shkronja. U ndoq ajo traditë që e vëmë re edhe te autorë të tjerë të shekullit XIX, si Zef Jubani, Pashko Vasa etj.. Kështu alfabeti i shoqërisë 'Bashkimi' mund të konsiderohet vijim i sistemit shkrimor të këtyre autorëve. Fjalori i kësaj shoqërie pati jehonë, duke e mbështetur shumë organe dhe shkrimtarë të dëgjuar," thekson Asani.

Gjergj Fishta prezantoi fjalorin e "Bashkimit"

Në gusht të vitit 1908, shoqëria "Bashkimi" shpërndau një deklaratë, ku shënonte veprat që kishte botuar gjatë periudhës së ekzistencës prej 10 vjetësh, duke vënë në dukje edhe përparësitë e alfabetit të saj. Me këtë donte t'i tregonte opinionit të kohës vlerat e kësaj shoqërie, veçanërisht në fushë të alfabetit. Edhe në parathënien e këtij fjalori flitet për përparësitë e përdorimit të këtij fjalori në të ardhmen për të shkruar gjuhën shqipe. E njohur për aktivitetin patriotik, Shoqëria "Bashkimi" mori pjesë në Kongresin e Manastirit, me At Fishtën dhe Luigj Gurakuqin. Fishta luajti një rol të veçantë dhe arriti të zgjidhej kryetar i komisionit të hartimit të alfabetit të shqipes. Delegatët e ngarkuan me një detyrë të tillë për erudicionin e thellë, kulturën e gjerë, forcën e fjalës, mendjen e mprehtë dhe logjikën e fortë. Poeti ynë tashmë kishte bërë emër jo vetëm në Veri, por edhe në Jug. Edhe sistemi shkrimor i kësaj shoqërie pati ndikim te zgjidhja përfundimtare e alfabetit që u miratua në Kongresin e Manastirit. Kështu, alfabeti i sotëm u udhëhoq nga parimi i zbatuar në alfabetin e shoqërisë "Bashkimi", i përfaqësuar nga At Gjergj Fishta, në përdorimin e dyshkronjëshave, që patjetër ka luajtur rol vendimtar. Shoqëria "Bashkimi" me punën dhe botimet që kreu, i dha një nxitje lëvrimit të gjuhës shqipe dhe zhvillimit të letërsisë dhe tekstologjisë shqiptare.

Eugjen Merlika
Tiranë

FAMILJA SHQIPTARE NË SHEKUJ

Libri: Tomë Mrijaj, Gjeneza e familjes Mrijaj ndër Shekuj, New York, 2015.

"Asnjë peshë nuk është më e madhe se ajo e kujtimeve: dhe ndoshta për këtë arsye të moshuarit, ashtu si ata që kanë shumë të tillë, ecin me një hap të ngadaltë dhe pothuajse të gjithë kanë shpinën e kërrusur."
Alfredo Panzini (1863–1939) shkrimtar italian

Të shkruash kujtimet do të thotë të nxjerrësh nga mjegulla e harresës një përvojë të gjatë të një jete të kaluar me të gjithë të mirat e të këqijat e saj, me çastet e zymta të humbjeve e ngjyrën gri, që mbulon pjesën më të madhe të ditëve, por edhe me momentet e pakta, por të ndritura të gëzimeve e kënaqësive familjare, të sendërtimit të ndonjë projekti, të mposhtjes të ndonjë tundimi, të pohimit e të mbrojtjes së atyre vlerave njerëzore, që i japin kuptimin qenies së species njerëzore e shëmbëllimit të saj me Krijuesin.

Kujtimet e një familjeje janë shuma e atyre të individëve, janë si rrathët, të cilëve u shtohet diametri e përmbledhin në hapësirën e tyre të gjithë ata më të vegjël, ashtu sikurse kujtesa e një populli është shumatoria e stërmadhe e kujtesave të individëve, të familjeve, të fiseve që përbëjnë bashkësinë e atyre njerëzve që flasin të njëjtën gjuhë e banojnë në të njëjtin truall. Me gjithë rëndësinë e madhe që marrin kujtimet në tërësinë jo lëndore të pasurisë së një kombi, duke shqyrtuar këto lloj rrëfimesh të përvojës sonë të shkuar, besoj se nuk duhet të kemi motive të veçanta kënaqësie, mbasi kujtimet, edhe të njerëzve të shquar, janë të pakta e të pamjaftueshme, për të ndihmuar shkruesit e historisë, ndërsa ato të tipit të këtij libri janë tepër të rralla.

Autori i kësaj vepre, shkrimtari e publicisti i njohur në mjediset intelektuale shqiptare mbarëkombëtare, z. Tomë Mrijaj, nëpërmjet faqeve të këtij libri, merr përsipër të lerë një histori të shkruar të familjes së tij të gjerë, jo vetëm për interesin e brezit të ri të saj, jo vetëm për të vënë në piedestalin e meritur të kujtesës fisnore e familjare personazhe të spikatur të tyre, por edhe për t'a inkuadruar atë në kontekstin e epokës së cilës i përket, duke u bërë dëshmitare e ecjes së një shoqërie në shtigjet e vështira të dy shekujve të fundit.

Vepra, është një rrëfim i gjatë, që thuret në kujtesa të disa brezave e përcillet nga njëri tek tjetri, nëpërmjet gojëve të të vjetërve, nëpër bisedat e "odave të burrave", që ishin logjet e kuvendeve, një formë ligjërimi e institucioneve të familjeve e të shoqërisë patriarkale shqiptare, shprehja më e lartë e sipranisë së urtësisë malësore, që udhëhiqte jetën normale të një Vendi, në të cilin institucionet shtetërore ishin shumë të mangëta e shpesh të paqena.

Rrëfimi fillon me një citim nga vepra e Frang Bardhit e vitit 1637 mbi katundin Kçirë, ku janë rrënjët e zanafillës së familjes dhe mbaron me përshkrimin e një dasme shqiptare në New York, në vitin 2006, ku dhëndëri është një nga më të rinjtë pinjoj të familjes e fisit të lashtë të autorit. Këta dy skaje kohore, brenda të cilëve përfshihen pak më pak se katër shekuj, janë dëshmi e një rruge të gjatë, të përshkuar nga njerëz të thjeshtë, pa tituj e ofiqe, njerëz, që në kodin e tyre deontologjik kishin vlerat më të çmuara njerëzore si ndershmëria, besa, dashuria për njëri tjetrin, respekti për mikun, për t'afërmin, për autoritetin moral, besimi në Zotin e besnikëria ndaj fesë së tyre.

Në këtë drejtim, fisi Mrijaj, është një pasqyrë e Shqipërisë historike dhe tradicionale, asaj të vlerave kombëtare e qytetare, duke u bërë shëmbëlltyrë përgjithësuese e familjes shqiptare gjatë shekujve. Në



këto familje përbërësja shoqërore e jetës familjare ka një peshë të madhe. Jeta familjare e shqiptarëve në shekuj ka qenë e lidhur me ngjarjet historike, me rrjedhën e rrëmbyeshme të tyre, me dallgët e rrebeshet e saj.

Autori, priret të nxjerrë në pah e të verë në dukje bëmat e paraardhësve të tij në fushën kombëtare. Episodet e ndryshme të kësaj natyre përshkruhen me shumë ngrohtësi dhe krenari. Ata përbëjnë pasurinë morale, që shërben si udhërrëfyese për brezat e rinj, si shembuj frymëzimi, si modele për t'u imituar. Historia e familjes fillon nga viti 1800, është histori pa dokumente të shkruara, i ngjan eposeve të lashta, që trasmetoheshin nëpërmjet aedëve dhe tingujve të lahutës e të çiftelisë. Para kësaj periudhe njihen vetëm emrat e vllaznive e të barqeve, të brezave të inkuadruar me përfaqësuesit e tyre deri në shekullin e 16-të, në kufijtë e legjendave.

Vepra, rrëfim i gjatë, që thuret në kujtesa të disa brezave e përcillet nga njëri tek tjetri.

Historia e familjes fillon me shpërnguljen e dy vëllezërve, Çunit dhe Zefit në Shkodër, nga fshati Kçirë i Pukës. Në kryeqendrën e Veriut, ata zhvillojnë një veprimtari të frytshme prodhuese të barutit e tregtimit të tij. Shfaqja e parë e veprës atdhetare të vëllezërve, lidhet me furnizimin me barut falas të malësorëve miq, që sjell si pasojë arrestimin e martirizimin e Çunit, që prehet prej gati dy shekujsh në varrezat katolike shkodrane të Rrmajit. Këtij gjesti heroik të të parit të familjes i shtohen, në rrjedhë të viteve, të tjerë episode trimërie si ai i Nikollë Mrijës në kullën e pashës së bashku me Fazlli Metën, vrasja në pabesi e Nikollës, qëndrimet e përfaqësive të Lugut të Drinit, të kryesuara nga burra të kësaj familjeje, në padi të masakrave serbe në Kosovë, pranë konsullatave evropiane në Shkodër, apo të bisedave të tyre me ministrat nacionalistë Ernest Koliqi e Kol Bib Mirakaj, në Tiranën e bashkimit me Kosovën e të tjera troje shqiptare.

Në këtë rrjedhë ndodhish e parakalime personazhesh të familjes Mrijaj që, në traditën më të mirë të mendësisë shqiptare, për të mbushur vatrën me fëmijë, shtohet e përhapet në trojet shqiptare, por edhe në botën e huaj, hyjnë edhe të tjera figura. Këto janë të lidhura me historinë shqiptare, në ngjarjet e së cilës familja Mrijaj është pothuajse gjithmonë e pranishme, por edhe me marrëdhëniet familjare, të krushqive apo shoqërore. Kështu, në këtë libër, në galerinë e ngjeshur të personazheve, hasim figura politike, si: Markagjoni, kapidani i Mirditës, Zef Ndoci, Ernest Koliqi, Kol Bib Mirakaj, Rexhep Krasniqi, Zef Nekaj, klerikë si mons. Zef Oroshi, Atë Tomë Xhaja, Atë Marian Prela, por edhe luftëtarja antikomuniste, martirja Marie Shllaku, apo mësuesi komunist Ndrec Ndue Gjoka etj.

Autori, nuk ka paragjykime politike, në përshkrimin e personazheve, ruan bindjet e tij atdhetare, i mbron ato në ballafaqimet me serbët, pushtues të Kosovës, por njësia matëse e vlerësimit mbetet gjithmonë përmasa njerëzore e dashuria ndaj atdheut.

Personazhet, që kanë shënuar historinë e familjes Mrijaj zënë një vend të posaçëm në vepër. Nikolla i parë, Mëhilli, Preni, Ndreca, Nikollë Preni, Ndue Jaku, Pren Nikolla, Tushi, Shtyti, Gjon Zef Marku, janë të gjithë burra trima e të zgjuar, njerëz të besës e të virtutit. Secili prej tyre përbën një stacion, ku ndalet mendimi i autorit në përshkrimin e rrugës së gjatë dy-shekullore të familjes së tij. Secili prej tyre është i rrethuar nga aureola e përgjithshme e respektit që e rrethon, por personaliteti më i shquar i familjes, për vlerat njerëzore, intelektuale dhe atdhetare, për njohjet e rolin e rëndësishëm, që luan në truallin e tij, si funksionar e si qytetar edhe falë jetës së tij të gjatë, është Nikollë Prend Mrijaj, babai i autorit.

Vepra "Kujtime" e Tomë Mrijës është një krijim bashkëkohor, persë i përket mesazheve që përcjell dhe vlerave që pohon. Edhe se përshkruan tablonë e Shqipërisë patriarkale, të një shoqërie të mbyllur në mendësi e ligje të pashkruara, që trashëgohen prej qindvjeçarësh në krahinat veriore e veri-lindore të Arbërit, në të spikat një qëndrim, do të thosha ultra modern, përse i përket koncepteve të familjes për gruan dhe të rinjtë. Gruaja, tek fisi Mrijaj, është një krijesë e respektuar, është engjëlli i vatrës që lind, rrit dhe edukon fëmijët, që pret e përcjell miqtë, që lartëson nderin e familjes, që vlerësohet nga pjesëtarët meshkuj të shtëpisë, që nga vjehrri e deri te fëmijët. Një kurorëzim i tillë, i figurës femërore nuk është i zakonshëm në mendësinë shqiptare, prandaj, për mendimin tim, përbën një risi konceptuale, që i rrit vlerën veprës dhe mesazhit të saj.

Familja Mrijaj, nis rrugën e saj me një ndodhi të dhimbshme, por të një rëndësie morale t 'admirueshme. Përballë vdekjes së parakohshme të burrit, nusja e Markut, djalit të Çunit, nënë e tre djemve, nga 12 deri në 16 vjeç, nuk pranon të braktisë fëmijët e të kthehet tek shtëpia prindore, siç e kërkonte zakoni e siç e urdhëronte xhaxhai i burrit. Mirditorja e bukur, Mrija, vendos të përballojë jetën e vetme e të rrisë djemtë. Kuptohen sakrificat e panumërta të burrneshës, për të sendërtuar projektin e saj, që shpërblehet me vendimin e djemve, për të adoptuar emrin e nënës si mbiemër të familjes. Nëse nuk është e vetme kjo histori, besoj se është tepër e rrallë në malësitë tona. Ai mbiemër mbeti e u njoh në shumë breza, në shenjë respekti e mirënjohje, për fisnikërinë vetëmohuese të një gruaje, e cila mbi të gjitha, në jetën e saj, i dha përparësi ndjenjës së nënës. Ajo ndjenjë fitoi mbi ligjet e maleve, mbi paragjykimet e shoqërisë, mbi moralin e saj. Ajo grua

i dha shoqërisë një mësim të madh, atë të respektimit të ligjeve të zemrës, të parimeve universale të detyrës së nënës, që nuk mund e nuk duhet të jetë në kundërshtim me pjesëmarrjen në një familje, në një fis, në një bashkësi njerëzish, mbasi detyra e nënës është më e bukura, më fisnikja më e bekuara nga Zoti, sepse është sendërtimi i mësimit të tij themelor. Si e tillë ajo bëhet themeli mbi të cilin ngrihet një familje me një histori dyqind vjetësh.

Janë personazhet qe kane shënuar historinë .

Në galerinë femërore të veprës së Tomë Mrijajt, gratë zonja stolisin kullat malësore, po ashtu si kuvendin e motrave murgesha në Kosovë, por ato i gjejmë edhe në aulat e universiteteve e në përgjegjësitë, edhe të mëdha, në shoqëritë më të përparuara të botës së sotme. Në këtë tablo të larmishme, mendoj se shquhen veçanërisht dy gra, përkatësisht nëna dhe bashkëshortja e autorit. Nëna, përbën kapitullin më prekës të librit e njëkohësisht brengën e pasosur të shkrimtarit, sepse nëna u nda përgjithmonë nga kjo jetë kur ai ishte vetëm dy vjeç e populli ynë thotë: "Fëmija pa nanë si nata pa hanë". Dila fisnike shkoi në qiell, duke marrë me vete dhimbjen e pasosur për vogëlushët e saj, edhe se të tjera gra si gjyshja Lizë apo gruaja e xhaxhait, Tone, do të plotësonin me dashurinë e kujdesin e tyre, në zemrat e fëmijëve, zbrazëtirën, që linte largimi i nënës.

N'atë ditë të zezë për familjen, baba Ndue, në një çast dëshpërimi të thellë, i drejtohet nipit të tij: "Nikollë! Sot duel ora nga konaku ynë". Ky ishte vlerësimi i të zotit të shtëpisë, tregues i ngrohtësisë, që shënonte raportet në familje, që mbetej e bashkuar dhe e fortë edhe para provave më të vështira e më të dhimbshme. "Bota e madhe e nënës, ka për të gjithë ne, një rrëqethje loti të kristaltë, ajo ka bukuri, sepse mbart mbi vete një univers ndjenjash të pafundme..." Sa e ndjerë aq edhe filozofike kjo frazë, që autori e ve në gojën e vëllait të madh, por që shpreh dhimbjen e të gjithë fëmijëve, për mungesën e nënës.

Liza Mrijaj, bashkëshorte e autorit, është një nga personazhet më përfaqësuese të gruas në familjet shqiptare, në një kontekst tjetër nga ai i zakonshmi, i mjedisit të njohur para dhe pas Pavarësisë. Gjysma e dytë e shekullit të shkuar, krahas kllapisë fiziologjike të shoqërisë shqiptare, si pasojë e ushtrimit të diktaturës më t'egër të provuar në gjithë historinë e saj, i përballoi shqiptarët, në një pjesë relativisht të vogël të tyre, me dukurinë e mërgimit, për arsye politike dhe ekonomike. Mërgimi i vuri ato familje shqiptare, që patën fatin t'a provojnë, në situata të tjera, larg atyre të vendeve të lindjes, me jetën e thjeshtë në mjediset familjare e fisnore, që prirej fuqishëm në pohimin e vlerave të të qe nurit në bashkësi, gjë e cila ndihmonte uni formimin e

përvojave, por edhe të personaliteteve njerëzorë mbi bazën e skemave dhe rregullave të njohura e të pranuara prej shekujsh.

Mërgimi, kishte të tjera kërkesa, të tjera kritere bashkëjetese shoqërore, për pasojë duhej përshtatja e plotë me rregullat dhe ligjet e shoqërive të përparuara, me respektin e përpiktë të tyre, me përpjekjen më të vullnetshme, për t'u integruar sa më cilësisht n'ato shoqëri.

Liza Mrijaj, është një shembull tipik i kësaj gjendjeje të re. Familja e saj, origjinare nga një fshat i Pukës, largohet nga Shqipëria e shkon në Kosovë, për t'i shpëtuar përndjekjes komuniste. Liza lind në Podujevë të Kosovës, për të filluar prej andej endjet nëpër botë. Ishte tre vjeçe, kur familja largohet nga Jugosllavija e merr strehim politik në Belgjikë. Ishte 11-vjeçe, kur familja shpërngulet për në SHBA-ës. Këtu fillon sfida e vështirë e vajzës malësore, me qytetërimin e mbifuqishëm botërore. Kjo kryhet nëpërmjet të vetmit mjet, që ajo mund të kishte në dorën e saj: vullnetit për të studiuar e zgjuarsisë, që e lehtësonte atë proces. Kështu vajza e vogël, në sajë të tyre, mundi t'i kalojë të gjitha etapat e shkollës deri në diplomimin në ekonomi.

Që nga ai çast jeta e saj njeh suksese, në punë e në karrierë. Por vajza kishte formuar një horizont të gjerë, që i siguronte drejtpeshimet e nevojshme në sfidat e jetës. Këtë të fundit e koncepton jo vetëm si qëllim realizimi profesional, por edhe vetjak në plotësimin e misionit njerëzor të krijimit të familjes, nëpërmjet dashurisë së çiltër në një Vend të lirë. Kariera dhe jeta familjare për Lizën shkojnë në hulli paralele, nuk e pengojnë njëra tjetrën, sigurisht edhe për meritë të bashkëshortit, që i sheh problemet me të njëjtin kënd vështrimi.

Sot Liza Mrijaj, punon në qytetin Yonkers, është një grua e realizuar në jetën e saj shoqërore, me një karrierë për t'u pasur zili edhe nga vetë amerikanët, një bashkëshorte e nënë shembullore, për të cilën familja është çerdhja e prehjes, e dashurisë, e sodis aksionit më të madh. Por ajo është edhe një shqiptare

atdhetare shumë e mirë, që jeton prej së largu intensivisht dertet e hallet e Shqipërisë e të Kosovës e që nuk mungon të gjejë rastin, për t'i vizituar e për t'i prekur me dorë ato. Ajo ka rritur fëmijë të lindur në Amerikë, duke kultivuar tek ta vetëdijen e origjinës, gjuhën e të parëve, traditën e tyre, në një simbiozë të bukur me Tomën, duke arritur ata rezultate.

Shembulli i kësaj gruaje intelektuale shqiptare, frymëzon optimizëm tek lexuesi i intervistës së saj, por njëkohësisht e detyron të kthehet mbrapa me mendim në diktaturën komuniste shqiptare, e cila gra me shtatin moral e intelektual të saj, i ekzekutoi, i burgosi, i internoi për gjysmë shekulli, duke i kthyer në skllave, duke bërë të pamundur ndihmesat e tyre, për përparimin e Shqipërisë. Intervista e saj, plotëson librin e kujtimeve të familjes, duke qenë një dëshmi e bukur e personalitetit të kësaj zonje që, në traditën më të mirë të gruas fisnike shqiptare, e ka fituar më së miri sfidën e saj komplekse me qytetërimin.

Një tjetër aspekt interesant i kësaj vepre është edhe roli i të rinjve në historinë e familjes Mrijaj. Ata gjejnë gjithmonë vendin e tyre, në përshtatje me aftësitë, shkollimin e vullnetin për të punuar. Njëzet vjeçare në drejtim të komunës apo të familjes, janë dëshmi e faktit se mendësia tradicionale fisnore dhe mjedisi rrethues asnjëherë nuk bëhen pengesë për të shpalosur aftësitë e prirjet e të rinjve. Kjo shpalosje e parimit të meritokracisë, mungesën e të cilit kemi një shekull që e paguajmë shumë shtrenjtë në funksionimin e Shtetit dhe institucioneve të tij, është një vlerë e shtuar, jo vetëm për familjen Mrijaj, por edhe për mjediset malësore, ku jeton ajo. Ajo mbetet një dukuri shumë pozitive që, së bashku me respektin ndaj gruas dhe figurës së saj, në jetën familjare e shoqërore, dëshmojnë një koncept tepër të përparuar e bashkëkohor, për t'u pasur zili edhe në mjediset intelektuale të bashkësisë shqiptare.

Libri "Kujtime", që i jepet lexuesit shqiptar sot, është një vepër me vlerë e shkrimtarit Tomë Mrijaj. Ai hedh dritë jo vetëm mbi historinë e shkuar e të sotme të familjes e fisit të tij, por edhe se merr forcë përgjithësuese nga përvoja të ngjashme në hapësirën gjeografike së cilës i referohet, ruan të veçantën e saj. E përgjithshmja dhe e përveçmja, vetjakja dhe historikja ujdisen bukur në lidhmëni e mirëkuptim me njëra tjetrën, duke na përcjellë një mesazh njerëzor të rëndësishëm, që shprehet shkurt në fjalët e një shkrimtari e dramaturgu francez, Jean Louis Auguste Commerson (1802 – 1879): "Të jetosh do të thotë të kujtosh".

Tiranë, Mars 2015

Dom Nikë Ukgjini
Shkodër

DOM FRAN MARKIQI
NjË GJYSMË SHEKULLI JETË MESHTARIE (1965-2015)

Me 25 korrik 2015, në Ljarë, Kryedioqeza e Tivarit u kremtua 50 vjetori i punës në shërbim të Zotit e popullit.

Dom Fran Markiqi, kremtoj 50 vjetorin e meshtarisë, pikërisht aty ku i kishte filluar hapat e parë të jetës se tij meshtarake në Ljare. Mesha që udhëhequr nga Dom Frani në Kishën e Shën Pjetrit, ku morën pjesë: Arqipeshkvi i Tivarit, Mons.Zef Gashi; ipeshkvi i Kotorrit, Mons. Ilia Janiq, meshtar nga gjithë dioqeza si dhe nga Kryedioqeza e Shkodrës. Festuesi në predikimin e tij kujtoj ditët e lumtura, por edhe ato të vështira që i kaloj në këtë famulli bjeshkore, duke ia dedikuar çdo gjë Zotit dhe popullit të kësaj zone legjendare. Në meshë pati përshëndetje të rastit si dhe dhurata të ndryshme dedikuar Dom Franit. Gjatë drekës të organizuar nga banoret e zonës, fjalën përshëndetëse e mori dhe Dom Nikë Ukgjini në emrin e Kryeipeshkvit të Shkodrës.

Dom Frani ka lindur me 23 tetor 1937, në Kllezën të Nalt, prej prindërve Zefit dhe Mrikës. Ishte djali i katërt prej pesë fëmijëve qe kishte kjo familje bujare me prejardhje të lasht nga Mirëdita e kapedanit Prek Bib Dodës. Shkollën fillore, tetëvjeçare i kishte krye në Kllinzën dhe Vladimir në gjuhen shqipe. Pas vendimit për tu bërë meshtar shkollimin e vazhdoj në vitin 1954, në Zarë të Kroacisë, për t'i vazhduar më pas studimet filozofike dhe teologjike në fakultetin teologjik në Zagreb. Shugurimin meshtarak e merr me 27 Dhjetor 1964 në Tivar, duke e filluar kështu jetën e tij të gjatë meshtarake. Nga viti 1965 punon në Ljare e Shestan pa ndërpre deri me sot. Gjatë kësaj kohe ka rinovuar, Kishat në:Llukiq, Dobrec, Marstjepoviq, Karanikiq, Brisk të poshtëm Gjuraq, Ljare etj. Në këto zona përkundrejt dominimit gjuhës sllave: në shkolla, medie administratë, etj., ritet fetare meshën gjithmonë Dom Frani guximshëm i ka celebrua në gjuhen shqipe.

Në vitin 1999, emërohet famullitar në Shtoj të Ulqinit,por duke mbetur edhe me tutje i lidhur me famullin e Ljarës.

As në pjesën fushore të Shtojit nuk pati rahati, por në vitin 2002, me ndihmën e mërgimtarëve nga Amerika filloj punën në ndërtimin e Kishës së re gjigante kushtuar Shën Markut Apostull e cila u inaugurua në vitin 2006.

Jeta e tij shumëvjeçare, u shoqërua me qëndresë në momente të vështira të jetës sociale, politike, shoqërore, spikasin gjithashtu përvujtëria, maturia dhe guximi, që sollën të mira të shumta popullit të cilit i shërbeu me devocionin e duhur për 50 vite me radhë. Po kështu marrëdhëniet e mira me tre breza ipeshkvijsh dhe me meshtarët e kryedioqezës, ka qenë dhe janë virtyti i lart i Dom Fran Markiqit. Urime dhe jetë të gjatë.

PUNIME ME VLERË
NË OBORRIN E KATEDRALES SË SHKODRES

Katedralja e Shkodrës nga shek. i XIX, një nder simbolet me të spikatura të katolicizmit shqiptar këto ditë do marr një pamje të re në rastin e sistemimit ambienteve për rreth e qark saj.
Ideja i ripërtëritjes se hapësirës se jashtme për shkak të kërkesave të kohës, ishte e Arqipeshkvit Mons. Angelo Massafra dhe famullitarit të Shkodrës Dom Artur Jaku.
Nevoja e riorganizimit të kësaj pjese hapësinore ishte qe ajo të jetë sa ma denjitoze, dhe funksionale në shërbim të vizitorëve të shumtë nga brenda dhe jashtë vendi. Po ashtu edhe nga dëshira për t'i dhënë serish dekorin e duhur këtij vendi te Shenjt dhe historik, me rastin e 25 vjetorit të lirisë fetare dhe meshës se parë të celebruar me 4 nëntor nga Dom Simon Jubani. Kjo hapësirë është konceptuar qe të jetë një vend shtegtimi i mirëfilltë edhe me rastin e përfundimit të procesit të kanunizimit të dyzet martirëve si dhe pikë referimi e rëndësishme për turizmin fetar e kulturore në veri të vendit.
Hapësira e jashtme do jetë në funksion të realizimit të Muzeut Dioqezan, i cili është në krijim e sipër.
Projekti është ideuar nga arkitektetja, Ester Pagnoni në bashkëpunim me Simona Basilico, dhe ka tre faza punimesh.
Në fillim të gushtit të këtij viti, kanë filluar punimet në fazën e parë, ku është duke u punuar në oborrin para Katedrales në heqjen e inerteve dhe pritet hedhja e bazamentit për shtrirjen e pllakave dekorative dhe krijimi i ambienteve të gjelbërta, bazuar në projektin në fjalë.

Njëherazi është duke u punuar edhe në krijimin e ambienteve te përshtatshme për ekspozimin e objekteve muzeale të mbledhura më kohë në popull sipas porosisë se Arqipeshkvit Mons. Massafra.
Dinjiteti i një (krye) dioqeze vlerësohet më mirëmbajtjen e Selisë Ipeshkvore dhe Katedrales e cila është nëna e të gjitha kishave të dioqezës.
Prandaj, të gjithë duhet të angazhohemi qe projekti në fjalë të jetësohet sa më parë.

D . Nika

VITRINË LIBRI



Ndoc Nikaj

SHKODRA E RRETHUEME

Vatra, Shkup 2012

Sabri Maxhuni

ZBATUESIT E ELABORATIT TË QUBRILLOVIQIT

Prishtinë 2015

NJAZI KAZAZI

ZHVILLIMI I ARSIMIT TË MESËM NË SHKODËR

Rozafa, Shkodër 2014

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë